

FSK-ja merr pjesë në një nga ushtrimet më të mëdha shumëkombëshe në Gjermani FAQE 3



Na ndiqni edhe në:

www.epokaere.com



facebook.com
Gazeta "Epoka e re"

AWR **ABBRUCH** GMBH
www.awr-abbruch.de

TROMP PËR VENDIMIN E HAGËS: ÇDO GJYKIM QË NUK REZULTON ME PAFAJËSI TË PLOTË DHE PA KUSHTE TREGON SE SPECIALJA ËSHTË INSTRUMENT POLITIK. FAQE 4-5



"Populli i Kosovës nuk pret asgjë më pak se një pafajësi të plotë, sepse e njeh realitetin historik të asaj që ndodhi në Kosovë gjatë

viteve '90, arsyet pse ndodhi dhe mënyrën se si u zhvillua lufta çlirimtare", ka theksuar në një intervistë për "Gazetën Express",

profesoresha kroate dhe autorja e librit për gjyqin e papërfunduar ndaj Millosheviqit, Nevenka Trump

AKTUALE



TRUMPI: LUFTA ME IRANIN
DO TË PËRFUNDJË MENJËHERË
PAS ZGJEDHJEVE NË SHBA F. 2

MONITORUESI I BE-së: GUSHTI,
MUAJI MË I NXHTË I REGJISTRUAR
NDONJËHERË F. 2

DOGANA PARALAJMËRON: 430 EURO
ËSHTË KUFIRI PA TAKSA PËR
MALLRAT PERSONALE NË AEROPORT F. 7

EKONOMI



BQK-ja DHE SEKTORI BANKAR
AVANCOJNË PËRGATITJET PËR
FUNKSIONALIZIMIN E PAGESAVE
TË SHPEJTA PËRMES PROJEKTTIT
TIPS CLONE F. 8

KEK-u NDAL NJËSINË A4 PËR
ARSYE TEKNIKE F. 8

SPORT



MBI 1.7 MILION EURO DO TË
INVESTOHEN NË PALESTRËN
SPORTIVE NË ISTOG F. 11

ÇMIMET
Ë KONSUMIT
NË KOSOVË
RRITEN 7.3
PËR QIND
NË MUAJIN
GUSHT F. 3



OVLUÇK-JA:
KËRKËSAT E
ZPS-SË NUK MUND
TA FSHEHIN
DËSHTIMIN E NJË
PROKURORIE TË
NJËANSHME F. 5



RENOVA
PUTZ
Macedoni
Xhepçisht - Tetovë
Gurëz-Ferizaj
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009
+389 44 487 755
Fax: +389 44 487 200
Mok: +377 44 501 289
E-mail: renova@mt.net.mk

PRINCESHA
GROUP SH.P.K.
NDËRTIM
PROJEKTIM
SHITJE
INFO: 049-111-101,
044-511-177
www.princesha-ks.com

Bunjamini
FABRIKA E LLAQEVE
MITROVICË
044/256-051
044/367-061
028/532-617

Kolegji BIZNESI
www.kolegjbiznesi.com
info@kolegjbiznesi.com
030 500 878 | 045 500 878
044 500 878 | 049 500 878

SIGMA
VIENNA INSURANCE GROUP
SIGMA INTERBANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SHA
DEGA KOSOVË
Rruga "Pashko Vasa", p.n. Prishtinë, Kosovë,
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302,
E-mail: info@sigma-ks.net | www.sigma-ks.net

INFINITY
Digital Agency
Endrit Shaqiri
+38344685122
Internet Website,
Marketing...

TRUMPI: LUFTA ME IRANIN DO TË PËRFUNDOJË MENJËHERË PAS ZGJEDHJEVE NË SHBA

UASHINGTON, 10 SHTATOR - Presidenti amerikan Donald Trump tha se beson që lufta me Iranin, që ka nisur mbi gjashtë muaj më parë, do të përfundojë “menjëherë” pas zgjedhjeve të mesmandatit që do të mbahen në nëntor në Shtetet e Bashkuara. “Mendoj se lufta do të përfundojë menjëherë pas zgjedhjeve”, sepse Irani “nuk mund të rezistojë më”, u tha Trump gazetarëve më 9 shtator. Ai e akuzoi Teheranin se është “i dëshpëruar për të ndikuar” në

zgjedhje. Lufta me Iranin pritet të jetë një çështje e rëndësishme në zgjedhje. Konflikti është jopopullor për shumë amerikanë, ndërkaq rritja e çmimeve të karburanteve, që lidhet me luftën, po shton presionet ekonomike me të cilat përballen votuesit. Në deklarin e tij për gazetarët, Trumpi tha se ShBA-ja nuk po kërkon një marrëveshje për t'i dhënë fund luftës me Iranin, megjithëse

shtoi se mund të zhvillohen negociata. Në qershor, Teherani dhe Uashingtoni nënshkruan një memorandum mirëkuptimi që synonte t'u jepte fund armiqësive, por marrëveshja dështoi. Javët e fundit palët janë përfshirë në sulme reciproke, për të cilat vëzhguesit thonë se mund të rrezikojnë që ta përshkallëzojnë konfliktin dhe konflikti të kthehet në një luftë në shkallë të plotë.



KRYEMINISTRI NORVEGJEZ: AEROPLANI I ZELENSKYT PËR PAK SA NUK U GODIT NGA NJË DRON



OSLO, 10 SHTATOR - Aeroplani me të cilin po udhëtonte presidentin ukrainas Volodymyr Zelensky, për në Oslo, ku mori pjesë në ceremoninë e varrimit të mbretit të Norvegjisë, “për pak sa nuk u godit” nga një dron gjatë nisjes nga Moldavia të martën, tha të mërkurën kryeministri norvegjez Jonas Gahr Store për transmetuesin publik NRK. “Aeroplani i tij për pak sa nuk u godit nga një dron teksa po nisej nga Moldavia. Ky është realiteti me të cilin përballlet ai”, tha Store.

Store nuk dha hollësi të tjera për këtë incident. Të mërkurën Zelensky mori pjesë në ceremoninë mortore të mbretit Harald V të Norvegjisë, duke marshuar pas arkivolit të tij së bashku me krerë të tjerë shtetesh në qendër të Oslos. Ndërkaq, pas ceremonisë së varrimit të mbretit të Norvegjisë, Zelensky u largua nga ky shtet dhe u nis drejt Kanadasë për bisedime me udhëheqësit atje, tha Store për NRK. Gjatë qëndrimit në Oslo, Zelensky u takua me

kryeministrin Store, me ministrin norvegjez të Financave, Jens Stoltenberg dhe atë të Jashtëm, Espen Barth Eide, me të cilët bisedoi për ndihmën ushtarake të Norvegjisë, përfshirë ndihmën për mbrojtjen ajrore dhe mbështetjen për civilët. Zelensky, vendi i të cilit përballlet me pushtimin në shkallë të plotë të nisur nga Rusia më 2022, vazhdimisht u kërkon shteteve aleate të Ukrainës sisteme të mbrojtjes ajrore për t'iu kundërvënë sulmeve ruse.

MONITORUESI I BE-SË: GUSHTI, MUAJI MË I NXEHTË I REGJISTRUAR NDONJËHERË

SUEL, 10 SHTATOR - Monitoruesi i klimës i Bashkimit Evropian tha të enjten se gushti ishte muaji më i nxehtë i regjistruar ndonjëherë në botë, teksa temperaturat e oqeanëve arritën gjithashtu nivele të paprecedentë dhe Evropa Perëndimore shënoi verën më të nxehtë. Në përgjigje të vlerësimit të Shërbimit të Kopernikut për Ndryshimet Klimatike, Kombet e Bashkuara paralajmëruan se derisa njerëzimi të heqë dorë nga lëndët djegëse fosile, planeti do të zhytet gjithnjë e më thellë në terrene të panjohura. Vëzhgimet e Kopernikut datojnë që nga viti 1940, por dëshmi të tjera - si mostrat e akullit, unazat e pemëve dhe skeletet e koraleve - u mundësojnë shkencëtarëve ta vendosin klimën e sotme në një kontekst historik shumë më të gjatë. “Njerëzit nuk kanë përjetuar temperatura aq të larta sa sot, me shumë gjasë, të paktën gjatë 100 000 vjetëve të fundit”, tha për AFP-në Samantha Burgess nga Qendra Evropiane për Parashikime Meteorologjike Afatmesme, e cila mbikëqyr Kopernikun. Temperaturat mesatare globale



të ajrit në gusht ishin 16.96 gradë celsius, tha Koperniku - 0.01 gradë më shumë se rekordi i mëparshëm brenda një muaji, i vendosur në korrik 2023. Koperniku tha se i konsideron këta dy muaj bashkërisht më të nxehtë, duke pasur parasysh diferencën shumë të vogël në temperatura. Shkencëtarët thonë se aktiviteti njerëzor - kryesisht djegia e qymyrit, naftës dhe gazit - e ka ngrohur planetin për rreth 1.4 gradë celsius që nga periudha paraindustriale dhe ka rritur ashpërsinë dhe gjasat për episode të motit ekstrem.

Megjithatë, emetimet e gazeve serrë arritën nivele të reja rekord në vitin 2025. “Dëshmitë janë të pakundërshtueshme: ky është çmimi që po rritet si pasojë e varësisë së njerëzimit nga lëndët djegëse fosile dhe krizës globale klimatike që ajo po ushqen”, tha shefi i klimës në Kombet e Bashkuara, Simon Stiell, duke komentuar raportin e Kopernikut. Temperaturat e sipërfaqes së deteve në mbarë botën gjithashtu shënuan një rekord të ri ditor dhe u barazuan me rekordin për muajin gusht, pas tre muajsh të temperaturave

rekord të regjistruara në oqeanet e tokës. Më shumë se 90 për qind e nxehtësisë së tepërt nga emetimet e gazeve serrë është përthithur nga oqeanet, duke e mbrojtur tokën nga ngrohja, por me kosto të madhe për jetën detare, shkëmbinjtë koralorë dhe komunitetet bregdetare. Rekorde të reja u regjistruan në Atlantik dhe Mesdhe, por edhe në Paqësorin tropikal, ku fenomeni klimatik, El Njino, që vlerësohet se është më i fuqishmi në epokën moderne, po forcohet me shpejtësi. Shkencëtarët presin që rekordet të vazhdojnë të thyhen në muajt në vijim, teksa “Super El Njino” i afrohet intensitetit maksimal rreth dhjetorit, dhe që viti 2027 - e ndoshta edhe 2026 - të bëhet viti më i nxehtë i regjistruar ndonjëherë. “Ndryshimet klimatike e bëjnë çdo El Njino më të nxehtë dhe derisa ta ndalojmë djegien e qymyrit, naftës dhe gazit, muajt që thejnë rekordet e nxehtësisë do të vazhdojnë të vijnë”, tha Friederike Otto, shkencëtare e klimës në Kolegjin Imperial të Londrës. Koperniku tha se gushti “shënoi

fundin e verës më të nxehtë të Evropës Perëndimore”, e cila tejkaloi rekordin e vendosur më 2003. Sezoni nga qershori deri në gusht u karakterizua nga valë të njëpasnjëshme të forta të të nxehtë, të cilat detyruan autoritetet që t'i mbyllnin shkollat, thanë lumenj dhe përgatitën terrenin për zjarre shkatërruese. Nga mesi i korrikut deri në mesin e gushtit platforma evropiane e monitorimit EuroMomo vlerësoi se në Evropë pati më shumë se 32 000 të vdekur si pasojë e temperaturave të larta. Shkencëtarët nga rrjeti World Weather Attribution arritën në përfundim se një valë veçanërisht e fortë e të nxehtë në qershor do të kishte qenë “praktikisht e pamundur” të ndodhte pa ndikimin e ndryshimeve klimatike. Por, nxehtësia e jashtëzakonshme u ndje në mbarë globin. Të mërkurën Administrata Kombëtare Oqeanike dhe Atmosferike e ShBA-së tha se Shtetet e Bashkuara kanë përjetuar verën më të nxehtë të regjistruar ndonjëherë.

KGJK-ja SHQYRTON DËRGIMIN E ÇËSHTJES SË BUXHETIT NË KUSHTETUESE

PRISHTINË, 10 SHTATOR - Këshilli Gjyqësor i Kosovës (KGJK) po shqyrton mundësinë që çështjen e ndërhyrjes së Qeverisë në buxhetin e Këshillit ta dërgojë në Gjykatën Kushtetuese për shkak të mungesës së theksuar të mjeteve financiare. Drejtori i përgjithshëm i Sekretariatit të KGJK-së, Shkëlzen Maliqi, tha se aktualisht Këshilli ka mbi 3.5 milionë euro detyrime ndaj operatorëve ekonomikë dhe për kompensimin e personave të dënuar pa bazë, ndërsa kërkesa buxhetore e KGJK-së për vitin 2026 është miratuar rreth 15 milionë euro më pak se shumata e kërkuar. “Unë e kam paraqitur në detaje para Asamblesë së Kryetarëve gjendjen buxhetore që kemi. E kemi njoftuar edhe më herët se kërkesa buxhetore e Këshillit për vitin 2026 është miratuar me rreth 15 milionë euro më pak sesa kemi kërkuar”, tha Maliqi, raporton “Ekonomia Online”.

Ai theksoi se problem shtesë paraqet edhe mosbartja e mjeteve për menaxhimin e Pallatit të Drejtësisë, pas transferimit të kompetencave nga Ministria e Administratës Publike të KGJK-ja. “Me transferimin e kompetencave nga Ministria e Administratës Publike për menaxhimin e Pallatit të Drejtësisë, edhe pse

në marrëveshje është paraparë që buxheti të transferohet te Këshilli Gjyqësor, ai nuk është aprovuar dhe nuk është transferuar asnjëherë. Si rezultat i të gjitha këtyre mungesave, përfshirë edhe mungesat në subvencione për personat e dënuar pa bazë, në gjendjen aktuale buxhetore të Këshillit jemi mbi 3.5 milionë euro në minus, apo mjete që kemi borxh ndaj operatorëve dhe personave të dënuar pa bazë”, tha Maliqi.

Sipas tij, KGJK-ja po shqyrton mundësinë e lëvizjes së mjeteve mes kategorive buxhetore për t'i përballuar mungesat, ndërsa në tremujorin e fundit të vitit pritet t'i drejtohet Ministrisë së Financave me kërkesë për mjete shtesë. “Po bëjmë gjithçka që është e mundshme për të bërë lëvizje mes kategorive buxhetore, sidomos tek investimet kapitale, aty ku ka mungesë ose, si rezultat i vonësive në OSHP, nuk kemi arritur t'i realizojmë dhe t'i transferojmë. Por, patjetër që në tremujorin e fundit duhet t'i drejtohem Ministrisë së Financave me kërkesë për lejin e buxhetit për mbulimin e këtyre shpenzimeve. Në të kundërtën, nëse nuk miratohet buxheti, edhe sipas rekomandimit të Asamblesë së Kryetarëve për vitin 2027, të cilin e kemi



paraparë edhe në Kornizën Afatmesme të Shpenzimeve, vitin e ardhshëm do ta fillojmë me borxhe të mëdha”, tha ai.

Kryesuesi i KGJK-së, Rrustem Thaqi, tha se që nga themelimi i Këshillit si institucion i pavarur, nuk është përballur më herët me një situatë të tillë sa i përket mungesës së buxhetit. “Duhet të nënvizoj një fakt: Këshilli Gjyqësor, prej themelimit të tij si institucion i pavarur, asnjëherë nuk ka qenë në një gjendje më të vështirë sa i përket mungesës së buxhetit. Këtë e kemi bërë me dije te të gjitha institucionet përkatëse të vendit, te partnerët ndërkombëtarë dhe vendorë. Jemi të vetëdijshëm për gjendjen dhe kam thënë edhe më herët se, sikur Këshilli Gjyqësor të ishte një organizatë tjetër, atëherë do të

ishim pranë insolvencës”, tha Thaqi.

Thaqi paralajmëroi se mungesa e buxhetit po e dobëson kapacitetin e KGJK-së për t'i ushtruar përgjegjësitë e tij dhe mund ta cenojë pavarësinë e gjyqësorit. “Mungesa e theksuar e buxhetit, në fakt, e bën Këshillin Gjyqësor të pafuqishëm. Një Këshill që ta realizojë funksionin e tij ligjor dhe kushtetues duhet të ketë fuqi dhe kapacitete. Në gjendjen në të cilën jemi, duhet thënë hapur se mungesa e buxhetit cenon pavarësinë e gjyqësorit në veçanti”, tha ai.

Sipas Thaqit, refuzimi i kërkesave buxhetore pa arsytim dhe analizë të mirëfilltë pamundëson funksionimin normal të Këshillit dhe ndikon edhe në

administrimin e gjykatave. “Sido që të rrjedhë kjo çështje, do të adresohet në institucionet përkatëse. Sigurisht që refuzimi i kërkesave buxhetore pa një justifikim dhe pa një analizë të mirëfilltë thjesht pamundëson funksionimin normal të Këshillit në ushtrimin e detyrave të tij. Po flas në kuptimin e përgjegjësiave ligjore dhe kushtetuese si dhe në administrimin e gjykatave në përgjithësi. Kjo mungesë e buxhetit është theksuar si në pamundësinë e Këshillit për t'i realizuar objektivat e tij strategjike, ashtu edhe në funksionimin normal të gjykatave”, tha Thaqi.

Ndërkaq, Maliqi bëri me dije se në KGJK është diskutuar edhe mundësia që çështja e ndërhyrjes së Qeverisë në buxhetin e Këshillit të dërgohet në Gjykatën Kushtetuese. “Një prej diskutimeve që kemi pasur ka qenë edhe propozimi që ndoshta t'i drejtohem Gjykatës Kushtetuese sa i përket të drejtës së Qeverisë për të ndërhyrë në buxhetin e Këshillit Gjyqësor. Kështu që, edhe për këtë jemi të gatshëm, së bashku me Zyrën Ligjore dhe Departamentin për Buxhet, të bëjmë një propozim për Këshillin dhe, nëse Këshilli pajtohet, ndoshta ta shfrytëzojmë edhe këtë mjet juridik”, tha Maliqi.

FSK-ja MERR PJESË NË NJË NGA USHTRIMET MË TË MËDHA SHUMËKOMBËSHE NË GJERMANI

EPOKA
ERE

Qendresa RAMA

PRISHTINË, 10 SHTATOR - Kontingjenti i Forcës së Sigurisë së Kosovës, i përfaqësuar nga një kompani e këmbësorisë të Regjimentit të Tretë të Forcave Tokësore, mori pjesë në ushtrimin shumëkombësh “Saber Junction 26”, që është realizuar në Qendrën e Gatishmërisë Shumëkombëshe në Hohenfels, Gjermani.

Në kuadër të ushtrimit, kompania e FSK-së është integruar në Brigadën Ajrore 173 të Ushtrisë Amerikane, përkatësisht në Batalionin 3-504 “Blue Devils”.



Pas fazës së planifikimit, koordinimit dhe trajnimit adaptues, pjesëtarët e FSK-së janë angazhuar në operacione

të ndryshme në terren, duke përfshirë operacione të sigurisë në mbështetje të zbarkimit ajror të batalionit, patrulla

luftarake dhe operacione mbrojtëse.

Pjesëmarrja në “Saber Junction 26” i mundësoi FSK-së t'i zhvillojë më tej aftësitë e komandimit dhe kontrollit, planifikimit dhe ekzekutimit të operacioneve, si dhe ta rrisë ndërveprueshmërinë me Ushtrinë Amerikane dhe forcat e vendeve partnere.

Integrimi i kompanisë së FSK-së në një formacion shumëkombësh paraqet një mundësi të rëndësishme për testimin e aftësive në një mjedis kompleks dhe dinamik trajnues krahas njësive partnere.

Aktivitetet e kontingjentit të FSK-së u përçollën gjatë

“Observation Day” nga komandanti i Komandës së Forcave Tokësore, gjeneralbrigade Mehmet Lladrovci, së bashku me rreshter majorin e KFT-së, Naim Smakolli.

Vizita shërbeu për të parë nga afër angazhimin, integrimin dhe performancën e pjesëtarëve të FSK-së gjatë ushtrimit.

Pjesëmarrja në ushtrime të këtij niveli kontribuon drejtpërdrejt në ngritjen e gatishmërisë operacionale, profesionalizmit dhe kapaciteteve të FSK-së për të vepruar krah për krah me ushtritë partnere në operacione shumëkombëshe.

Rama kërkon votimin e themelimit të “Pastrimit”

PRISHTINË, 10 SHTATOR - Kryetari i Prishtinës, Përparim Rama, ka kërkuar nga asamblistët e kryeqytetit që në seancën e së premtes ta votojnë themelimin e Kompanisë Komunale “Pastrimi”.

Rama e ka cilësuar këtë si një prej vendimeve më të rëndësishme për Prishtinën,

duke thënë se gjendja me mbeturinat nuk mund të vazhdojë më në këtë mënyrë. Ai u ka bërë thirrje veçanërisht asamblistëve të Lëvizjes Vetëvendosje që ta mbështesin themelimin e kompanisë. “Qytetarët ju kanë votuar me marrë vendime që ua zgjidhin problemet. Bërllogu është në

lagjet ku jetoni edhe ju, në rrugët ku kalojnë fëmijët tuaj, në qytetin ku jetojnë familjet tuaja”, ka shkruar Rama.

Sipas tij, propozimi për themelimin e kompanisë është i gatshëm dhe zgjidhja për problemin është para tyre. “Votojeni!”, ka përfunduar Rama.





TROMP PËR VENDIMIN E HAGËS: ÇDO GJYKIM QË NUK REZULTON ME PAFAJËSI TË PLOTË DHE PA KUSHTE TREGON SE SPECIALJA ËSHTË INSTRUMENT POLITIK

“Populli i Kosovës nuk pret asgjë më pak se një pafajësi të plotë, sepse e njeh realitetin historik të asaj që ndodhi në Kosovë gjatë viteve '90, arsyet pse ndodhi dhe mënyrën se si u zhvillua lufta çlirimtare”, ka theksuar në një intervistë për “Gazetën Express”, profesoresha kroate dhe autorja e librit për gjyqin e papërfunduar ndaj Millosheviqit, Nevenka Trump

INTERVISTOI BESNIK VELIJA

Duke qenë se kanë mbetur më pak se dhjetë ditë deri më datën 16 shtator, cila është pritshmëria juaj për vendimin përfundimtar?

Nevenka Trump: Në aspektin institucional, Dhomat e Specializuara të Kosovës (DHSK) janë nën një presion të jashtëzakonshëm. Një pafajësi e plotë do të shihej nga kritikët si një dështim shumë-milionësh i drejtësisë ndërkombëtare, ndërsa një dënim gjithëpërfshirës do të konsolidonte përgjithmonë narrativën lokale se gjykata është një trupë e njëanshme dhe e motivuar politikisht. Pritshmëria ime është se çdo aktgjykim që nuk rezulton në një pafajësi të plotë dhe pa kushte do të shihet si prova përfundimtare se Dhomat e Specializuara të Kosovës janë një instrument thjesht politik, dhe jo një gjykatë e së drejtës. Ky institucion ka vuajtur nga një krizë e thellë legjitimiteti që nga themelimi. Ai ka funksionuar mbi një mandat

thellësisht të mangët dhe mono-etnik, i cili në mënyrë selektive vë në shënjestër viktimat e agresionit, ndërsa mbron autorët e vërtetë shtetërorë.

Ndjekja agresive nga Prokuroria e një dënimi prej 45 vjetësh për udhëheqjen e lartë të UÇK-së është një përpjekje e dëshpëruar për të justifikuar ekzistencën shumë-milionëshe të kësaj gjykate dhe për të mbuluar vite të tëra dështimesh institucionale, rrjedhjesh të informacionit dhe njëanshmërie sistematike.

Nëse gjyqtarët shpallin një aktgjykim fajësues duke u bazuar në doktrina juridike artificiale dhe të tejzgjatura, siç është Ndërmarrja e Përbashkët Kriminale (JCE), kjo nuk do të kontribuojë në legjitimitetin e sistemit të drejtësisë ndërkombëtare. Përkundrazi, do të konfirmonte se funksioni i vërtetë i kësaj gjykate nuk ka qenë kurrë vendosja e së vërtetës dhe kërkimi i drejtësisë, por zbatimi i një narrative politike të paracaktuar, të hartuar për ta qetësuar Beogradin dhe për të imponuar një simetri të rreme historike mes të gjitha palëve në luftërat e viteve '90.

Aktgjykimet duhet të pasqyrojnë realitetin politik dhe historik se Serbia ka qenë nxitësi kryesor i dhunës në shkallë të gjerë në tri luftëra, përfshirë luftën në Kosovë në vitet '90.

Ajo që ka ndodhur së fundmi me reagimet në Serbi pas vdekjes së gjeneralit Ratko Mlladiq tregon triumfalizmin e Serbisë, e cila, pavarësisht se i humbi të tria luftërat, ende arrin t'i shmangët përgjegjësisë dhe vazhdon të mbajë pretendimet e saj territoriale ndaj Kosovës dhe Bosnjë-Hercegovinës. Çdo aktgjykim fajësues ndaj liderëve të UÇK-së më 16 shtator 2026 do ta ushqente narrativën e Serbisë se ajo ka qenë pala e dëmtuar dhe do ta inkurajonte udhëheqjen e saj që të vazhdojë politikën e pretendimeve territoriale ndaj Kosovës.

Si i vlerësoni deklaratat e presidentit serb Vuçiç? Ai ka thënë se Thaçi do të dënohet vetëm në aktakuzën e dytë, për ndërhyrje në procedurë, ndërsa do të lirohet nga akuzat për krime lufte. A e shihni këtë si spin politik nga Vuçiçi, për qëllime elektorale në Serbi, apo mendoni se ai vërtet di

PRISHTINË, 10 SHTATOR - Nëse krerët e UÇK-së nuk do të shpallen plotësisht të pafajshëm, do të provohet përfundimisht që Gjykata Speciale është thjesht një instrument politik dhe jo gjykatë e së drejtës. Kështu ka thënë në një intervistë ekskluzive me shkrim për “Gazetën Express”, profesoresha kroate dhe autorja e librit për gjyqin e papërfunduar ndaj Millosheviqit, Nevenka Trump.

Ajo e ka cilësuar si doktrinë artificiale “ndërmarrjen e përbashkët kriminale” dhe thotë se nëse Gjykata vendos bazuar mbi një doktrinë të tillë, do të vërtetohej se Haga është bërë për ta qetësuar Serbinë dhe për të imponuar simetri të rreme mes palëve në luftërat e viteve '90. “Aktgjykimet duhet ta pasqyrojnë

realitetin politik dhe historik se Serbia ka qenë nxitësi kryesor e dhunës në shkallë të gjerë në tri luftëra, përfshirë luftën në Kosovë në vitet '90”, ka thënë Trump për “Express”.

Sipas Trump, çfarëdo vendimi për fajësi do ta nxiste Serbinë për t'u rikthyer te pretendimet territoriale ndaj Kosovës. Deklarimet e Vuçiçit rreth verdiktit final, Trump i sheh si një lojë politike dhe, sipas saj, lehtësia me të cilën flet Vuçiçi për një gjë të tillë, tregon se sa e ekspozuar dhe e cenueshme ndaj manipulimit politik është Gjykata Speciale.

Trump, e cila ligjëron në Universitetin e Amsterdemit, thotë se përçarjet politike në Kosovë në prag të një date kaq me rëndësi, do t'i shërbenin vetëm Serbisë.

ZPS-ja KËRKON DËNIM ME 6 VJET BURGIM PËR THAÇIN PËR PENGIM TË DREJTËSISË, MBROJTJA KËRKON LIRIMIN E TIJ



HAGË, 10 SHTATOR - Zyra e Prokurorit të Specializuar (ZPS) ka kërkuar që ish-presidenti i Kosovës, Hashim Thaçi, të shpallet fajtor dhe të dënohet me gjashtë vjet burgim në rastin për pengim të drejtësisë pranë Dhomave të Specializuara të Kosovës në Hagë. Mbrojtja e Thaçit, në anën tjetër, ka argumentuar se ZPS-ja nuk ka sjellë prova që arsyetojnë dënimin e kërkuar ndaj tij dhe ka thënë se ai duhet të lirohet nga të gjitha akuzat. Prokurori i specializuar, Joshua Hafetz, tha gjatë shpalosjes së deklaratave përmbyllëse se “akuzat që ZPS-ja ka ngritur dhe që ka vërtetuar janë krime”. “Përpjekja për të ndërhyrë dhe penguar procesin gjyqësor në këtë gjykatë, paraqet kërcënim për adresimin e drejtë të

drejtësisë”, tha prokurori Hafetz. Por, avokatja mbrojtëse e Thaçit, Sophie Menegon, kundërshtoi pretendimet e Hafetz, duke thënë se ZPS-ja po kërkon dënim për Thaçin “sepse i duhet t’i mbulojë dhe arsyetojë masat tejet ndërhyrëse që janë marrë ndaj zotit Thaci për muaj të tërë”. “Pra incizimi i fshehtë i të gjitha bisedave të tij dhe bisedave telefonike dhe bisedave jo të privileguara, përfshirë me bashkëshorten dhe djalin e tij”. Ajo theksoi se “provat janë të dobëta, akuzat e tyre janë të dobëta, qoftë nga ana ligjore apo faktike, dhe këto e arsyetojnë lirimin e Thaçit nga të gjitha akuzat e ngritura”. Në seancën e parë të shpalosjes së deklaratave përmbyllëse vetëm Thaçi është i pranishëm në

gjykatore, ndërsa të akuzuarit e tjerë janë duke e ndjekur seancën përmes videolidhjes. Mbrojtja dhe prokurorët do t’i kenë tri ditë kohë për t’i dhënë argumentet e tyre përmbyllëse në këtë rast që ndërlidhet me çështjen gjyqësore kundër Thaçit dhe tre ish-krerëve të tjerë të UÇK-së. Prokuroria tha se nëse Thaçi shpallet fajtor, dënimi për këtë rast do ta vuante “në vijim të ndonjë dënimi tjetër që do të jepet në rastin 6, nëse do të jepet”. Për të akuzuarit e tjerë në këtë rast, Prokuroria kërkoi që të gjithë të shpallen fajtorë dhe të dënohen me burgim. Prokuroria kërkoi që Hajredin Kuçi të dënohet me nëntë muaj burgim, ndërsa Fadil Fazliu, Isni Kilaj dhe Bashkim Smakaj të dënohen me nga tre vjet burgim secili.

Deklaratat përmbyllëse do të mbahen edhe të hënën e 14 shtatorit.

Dy ditë pas përfundimit të deklaratave përmbyllëse, Thaçi së bashku me Kadri Veselin, Jakup Krasniqin dhe Rexhep Selimin do të dalin

para trupit gjykues për t’u përballur me aktgjykimin për krime lufte gjatë luftës së viteve 1998-’99 në Kosovë. Për secilin nga ta, Prokuroria ka kërkuar 45 vjet burgim. Të katërtit i kanë mohuar të gjitha akuzat.

OVLUÇK-ja: Kërkesat e ZPS-së nuk mund ta fshehin dështimin e një prokurorie të njëanshme

Organizata e Veteranëve të Luftës së UÇK-së ka shprehur shqetësimin e saj të thellë lidhur me kërkesat e fundit të Prokurorisë së Specializuar për dënimin e Hashim Thaçit, Hajredin Kuçit, Fadil Fazliut, Isni Kilajt dhe Bashkim Smakajt në rastin e pretenduar të pengimit të drejtësisë. Sipas OVLUÇK-së, kërkesat e ZPS-së nuk mund ta fshehin dështimin e një prokurorie të njëanshme. “Për ne, këto kërkesa nuk janë befasi. Ato vijnë nga e njëjta Prokurori e Specializuar, e cila gjatë gjithë këtij procesi ka ndërtuar një qasje të njëanshme ndaj ish-pjesëtarëve të UÇK-së dhe ka ngritur akuza mbi një material të kontestueshëm, përfshirë edhe materiale të ardhura nga Serbia. Është e vështirë të mos shtrohet pyetja nëse, përballë dështimeve të saj në proceset e zhvilluara në Hagë, ZPS-ja sot po përpiket ta arsyetojë punën e vet

përmes një qasjeje edhe më ndëshkuese në rastin e pengimit të drejtësisë. Në vend se të reflektojë mbi dobësitë, kontradiktat dhe dështimet e provave të paraqitura në proceset e saj, Prokuroria vazhdon me kërkesa të rënda për burgim. Kjo nuk e forcon besimin në drejtësi. Përkundrazi, e thellon shqetësimin se kemi të bëjmë me një prokurori që ka ndërtuar një narrativë të paracaktuar ndaj UÇK-së dhe njerëzve që i shërbyen asaj. OVL UÇK nuk pret lajme të mira nga një Prokurori e tillë, megjithatë ne presim drejtësi nga gjykatësit. Vendimi duhet të mbështetet në ligj dhe në standardet më të larta të drejtësisë, e jo në narrativat e Prokurorisë. Lufta e UÇK-së nuk mund të kriminalizohet përmes proceseve të njëanshme dhe se drejtësia nuk mund të ndërtohet mbi paragjykitime politike”, është thënë në reagimin e OVLUÇK-së.

diçka?

Nevenka Tromp: Deklaratat e Vuçiqit janë një shfaqje arrogante e manipulimit politik dhe luftës psikologjike, e dizajnuar për të shfrytëzuar dobësinë e gjykatës. Duke parashikuar publikisht se Hashim Thaçi do të dënohet vetëm për ndërhyrje në dëshmitarë, ndërsa do të lirohet nga akuzat kryesore për krime lufte, Vuçiq po i ngre paraprakisht një kurth komunitetit ndërkombëtar dhe po e minon vendimin përfundimtar të gjykatës para se ai të lexohet. Nuk besoj se bëhet fjalë për informacion të brendshëm; kjo është një lëvizje e kalkuluar politike. Nëse Thaçi shpallet i pafajshëm për krimet e luftës, Vuçiq do ta shfrytëzojë këtë politikisht, brenda dhe jashtë Serbisë, për të pretenduar se Dhomat e Specializuara janë një farsë e plotë që mbron “terroristët shqiptarë”, duke

nxitur zemërimin nacionalist për përfitime elektorale në Serbi. Nëse Thaçi dënohet, Vuçiq do të marrë meritat për presionin e pandërprerë diplomatik të Beogradit. Fakti që një kryetar shteti i huaj, që përfaqëson regjimin agresiv të viteve ’90, ndihet komod të diktojë publikisht dhe të përcaktojë paraprakisht rezultatet e një gjykate që supozohet të jetë e pavarur, tregon se sa thellë të komprometuar, të ekspozuara dhe të cenueshme ndaj manipulimit politik janë Dhomat e Specializuara të Kosovës.

Meqë ky vendim mund të prodhojë zhvillime në Kosovë, cili është mesazhi juaj për popullin e Kosovës nëse Thaçi dhe të tjerët shpallen fajtorë për akuzat për krime lufte?

Nevenka Tromp: Nëse Hashim Thaçi dhe liderët e tjerë shpallen fajtorë, kjo padyshim do të

shkaktojë tronditje të thella, dhimbje dhe një ndjenjë padrejtësie ligjore dhe historike në shoqërinë e Kosovës, e cila gjerësisht i sheh këta figura si arkitektët e pavarësisë së saj. Vendosija e numëruesve mbrapsht në qytete si Ferizaj dhe Prishtina tregon se sa thellësisht personal dhe kolektiv është ky aktgjykim për qytetarët e Kosovës. Populli i Kosovës nuk pret asgjë më pak se një pafajësi të plotë, sepse e njeh realitetin historik të asaj që ndodhi në Kosovë gjatë viteve ’90, arsyet pse ndodhi dhe mënyrën se si u zhvillua lufta çlirimtare. Kjo gjykatë shihet si një institucion i imponuar nga jashtë, i cili për vite me radhë ka kriminalizuar në mënyrë selektive viktimën, ndërsa ka dështuar t’i trajtojë krimet strukturore të orkestruara nga aparati shtetëror serb. Vlerësimi

im është se populli i Kosovës nuk do ta pranojë që një gjykatë e huaj të rishkruajë historinë e tij apo të përcaktojë natyrën e luftës së tij për mbijetesë dhe liri. Çdo rezultat tjetër përveç një pafajësie të plotë do të shkaktonte në mënyrë të pashmangshme pakënaqësi të thellë popullore, protesta masive dhe trazira politike. Korniza juridike ndërkombëtare ka dështuar ta kuptojë se nuk mund ta kriminalizosh udhëheqjen e një lëvizjeje çlirimtare pa tentuar njëkohësisht ta delegjitimosh vetë shtetësinë e Kosovës. Qytetarët e Kosovës e dinë të vërtetën e historisë së tyre dhe asnjë aktgjykim i nxjerrë nga një gjykatë e shkëputur nga realiteti në Hagë nuk mund ta ndryshojë legjitimitetin e luftës mbrojtëse të UÇK-së.

Tani që vendimi do të merret pas

pak ditësh, a mendoni se Kosova do të duhej t’i kishte institucionet e reja të formuara dhe të mos ishte në këtë situatë të paqëndrueshmërisë politike, në mënyrë që të kishte një përgjigje më të fuqishme ndaj vendimit, po flas për skenarin më të keq?

Nevenka Tromp: Përballë një aktgjykimi të padrejtë ndaj arkitektëve të pavarësisë së saj, Kosova ka nevojë për një qëndrim të palëkundur, të unifikuar shoqëror dhe shtetëror. Kosova nuk mund t’ia lejojë vetes përçarjet dhe konfliktet e brendshme politike në këtë moment kaq të rëndësishëm. Përçarja e saj, në fund, do t’i shërbejë vetëm Serbisë. Pavarësia e Kosovës është e pakthyeshme, por Kosova, si një shtet funksional, mund të ecë përpara vetëm nëse interesi kombëtar përcaktohet qartë dhe pranohet përtej interesave konkurruese të partive politike.

106 MILIONË EURO PËR ENERGJI TË PASTËR: PËRURUHET PARKU I ERËS NË ZATRIQ

PRISHTINË, 10 SHTATOR - Kryeministri në detyrë i Republikës së Kosovës, Albin Kurti, mori pjesë në përurimin e Parkut të Erës, në fshatin Zatriq të komunës së Rahovecit. Kryeministri Kurti tha se Kosova ka potencial të madh për energji të ripërtërishme, prandaj “si Qeveri e Republikës së Kosovës kemi ndërmarrë hapa konkretë përmes investimeve të mençura dhe në interes të qytetarëve, por edhe për gjeneratat që vijnë pas nesh”.

Parku i Erës në Zatriq është një investim prej rreth 106 milionë eurosh, i cili do të mundësojë prodhimin vjetor të rreth 185 gigavat-orëve energji të pastër dhe t'i mbulojë nevojat vjetore për energji të rreth 45 mijë familjeve. “Ky park është veçanërisht i rëndësishëm edhe për sigurinë tonë energjetike. Çdo megavat orë i energjisë së pastër që prodhohet këtu është një hap drejt një Kosove më pak të varur nga burimet e kufizuara dhe më të ekspozuar ndaj

krizave të jashtme të energjisë”, tha kryeministri në detyrë Kurti. Duke falënderuar partnerët ndërkombëtarë financiarë për mbështetjen e tyre si dhe të gjitha institucionet e Republikës së Kosovës dhe ekipet profesionale, të cilët kanë punuar që ky projekt të bëhet realitet, kryeministri në detyrë Kurti theksoi se me këtë park të erës “po shtojmë një tjetër gur në themelet e një të ardhmeje energjetike më të pastër, më të sigurt dhe më të qëndrueshme në Kosovë”.



KUSARI-LILA DISKUTOI ME TEUTA SAHATQIJAN PËR FUQIZIMIN E TË RINJVE DHE GRAVE NË TEKNOLOGJI DHE NË INOVACION



PRISHTINË, 10 SHTATOR - Ministria në detyrë e Industrisë, Ndërmarrësisë, Tregtisë dhe Inovacionit, Mimoza Kusari-Lila, zhvilloi takim me ekspertin e transformimit digjital, specialistin e Inteligjencës Artificiale dhe Sigurisë Kibernetike, themeluesen e TDS Consulting dhe drejtoreshën e Women in Tech Kosovë, Teuta Sahatqija. Gjatë takimit u diskutua për zhvillimin e të rinjve në fushat e teknologjisë, transformimin digjital dhe mundësitë e reja

që po krijohen për ndërmarrësit e rinj dhe startup-et në këtë sektor. Një fokus i veçantë i diskutimit ishte fuqizimi i vajzave dhe grave në teknologji, inovacion dhe ndërmarrësi, me qëllim krijimin e më shumë mundësive për përfshirjen dhe kontributin e tyre në sektorët që po përcaktojnë ekonominë e së ardhmes. Ministria Kusari-Lila vlerësoi kontributin dhe përvojën e Teuta Sahatqijas në nxitjen e ideve transformuese,

zhvillimin e talentëve të reja dhe avancimin e një ekosistemi më të favorshëm për inovacionin dhe teknologjinë në Kosovë. Në këtë drejtim, Ministria e Industrisë, Ndërmarrësisë, Tregtisë dhe Inovacionit ka njoftuar se mbetet e përkushtuar, që përmes transformimit digjital, inovacionit dhe ndërmarrësisë të avancojë projekte strategjike që krijojnë më shumë mundësi për të rinjtë, fuqizojnë vajzat dhe gratë dhe mbështesin bizneset vendore.

VAZHDON PUNA PËR HARTIMIN E STRATEGJISË KOMBËTARE PËR MBROJTJEN NGA DHUNA NË FAMILJE, DHUNA NDAJ GRAVE DHE DHUNA ME BAZË GJINORE 2027-2031

PRISHTINË, 10 SHTATOR - Në ambientet e Ministrisë së Drejtësisë po mbahet takimi i radhës në kuadër të procesit të hartimit të Strategjisë Kombëtare për Mbrojtjen nga Dhuna në Familje, Dhuna ndaj Grave dhe Dhuna me Bazë Gjinore 2027-2031, me fokus në Objektivin Strategjik I - Politikën e Integruar. Gjatë takimit anëtarët e grupit punues, së bashku me përfaqësues të institucioneve të tjera të ftuar në kuadër të bashkëpunimit ndër-institucional, po kontribuojnë në hartimin dhe konkretizimin e këtij objekti strategjik. Në takim janë përfshirë edhe përfaqësues nga Zyra për Qeverisje të Mirë pranë Zyrës së Kryeministrit, Agjencia për Informim dhe Privatësi dhe



Agjencia e Statistikave të Kosovës, me qëllim të sigurimit të ekspertizës dhe perspektivave institucionale relevante për fushat që mbulon ky objektivi. Objektivi Strategjik I synon forcimin e politikave

gjithëpërfshirëse dhe të bashkërenduara, koordinimit dhe llogaridhënies institucionale në parandalimin dhe luftimin e dhunës në familje, dhunës ndaj grave dhe dhunës me bazë gjinore.

Gjatë diskutimeve u theksua rëndësia e forcimit të mekanizmave institucionale të koordinimit në nivel qendror dhe lokal, përcaktimit të qartë të përgjegjësisë institucionale, sigurimit të burimeve të

nevojshme financiare dhe njerëzore, si dhe bashkëpunimit të qëndrueshëm ndërmjet institucioneve dhe shoqërisë civile. Vëmendje e veçantë po i kushtohet forcimit të sistemeve për mbledhjen, menaxhimin dhe raportimin e të dhënave, harmonizimit të të dhënave dhe treguesve, si dhe zhvillimit të mekanizmave për monitorimin, vlerësimin dhe matjen e rezultateve dhe ndikimit të politikave. Puna e grupit punues do të vijojë me qëllim të hartimit të një strategjie gjithëpërfshirëse, të matshme dhe të zbatueshme, e cila do të adresojë në mënyrë të koordinuar parandalimin dhe luftimin e dhunës ndaj grave, dhunës në familje dhe dhunës me bazë gjinore.

Kreshnik Kačiu zgjidhet kryetar i Gjykatës Administrative

PRISHTINË, 10 SHTATOR - Këshilli Gjyqësor i Kosovës (KGjK), në takimin e 372-të, shqyrtoi raportin e Komisionit për shqyrtimin e aplikacioneve, intervistimin,

vlerësimin dhe rekomandimin e kandidatëve për pozitën e kryetarit të Gjykatës Administrative. Anëtarët e KGjK-së, sipas rekomandimit të Komisionit

Vlerësues për intervistimin, vlerësimin dhe rekomandimin e kandidatëve, pas zhvillimit të procesit të votimit, me shumicë votash zgjodhën Kreshnik Kačiu

kryetar të Gjykatës Administrative të Republikës së Kosovës. Mandati i tij është pesëvjeçar dhe do të fillojë nga data e hyrjes në fuqi të vendimit.



Aleanca Kosovare e Bizneseve mbështet “Marshin për Liri” më 12 shtator

PRISHTINË, 10 SHTATOR - Përfaqësuesit e platformës “Liria ka Emër”, Eliza Hoxha dhe Ridvan Emini, janë pritur në takim nga përfaqësues të Aleancës Kosovare të Bizneseve, të cilët kanë shprehur mbështetjen për “Marshin për Liri”, që do të mbahet më 12 shtator në Prishtinë, në përkrahje të Hashim Thaçit, Kadri Veselit, Jakup Krasniqit dhe Rexhep Selimit që po mbahen në Hagë.

Kryetari i AKB-së, Agim Shahini, tha se bizneset, punëtorët, bashkëpunëtorët dhe familjarët e tyre do t'i bashkohen marshit në mënyrë masive.

Në këtë takim përfaqësuesit e LKE-së i falënderuan përfaqësuesit e AKB-së për mbështetjen e ofruar, duke theksuar se Kosova po pret drejtësi, liri dhe kthimin në atdhe të çlirimtarëve.



GJASHTË DITË PARA AKTGJYKIMIT, ODA E MJEKËVE VENDOS FLAMURIN GJIGANT “LIRIA KA EMËR”

PRISHTINË, 10 SHTATOR - Vetëm gjashtë ditë para aktgjykimit të 16 shtatorit, Oda e Mjekëve të Kosovës i është bashkuar mesazhit të solidaritetit dhe mbështetjes për çlirimtarët, duke vendosur në objektin e saj një flamur gjigant me emblemën e UÇK-së dhe mbishkrimin “Liria ka emër”.

Flamuri është vendosur në fasadën e objektit të Odës, duke u bërë pjesë e aktiviteteve dhe mesazheve publike që po zhvillohen në prag të vendimit për Hashim Thaçin, Kadri Veselin, Jakup Krasniqin dhe Rexhep Selimin.

Ky solidarizim vjen në një kohë kur institucione, organizata, biznese, artistë, veteranë dhe qytetarë po bashkohen rreth një mesazhi të përbashkët për drejtësi, liri dhe mbrojtjen e historisë së Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës.

Vendosja e flamurit vetëm pak ditë para aktgjykimit bart edhe një mesazh të fuqishëm simbolik: liria e Kosovës ka një histori, një sakrificë dhe një emër që nuk harrohet. Aktivitetet vazhdojnë drejt Marshit për Liri, që do të mbahet më 12 shtator, nga ora 14:00, në sheshin “Skënderbeu” në Prishtinë.

Gjashtë ditë para vendimit, mesazhi po bëhet gjithnjë e më i madh: Liria ka emër.



‘ZJARRI I LIRISË’ NDIZET EDHE NË ZONËN OPERATIVE TË NERODIMES: LIRI PËR ÇLIRIMTARËT, NDERIM PËR UÇK-në



PRISHTINË, 10 SHTATOR - Edhe Zona Operative e Nerodimes, si pjesë e 7 zonave, i është bashkuar aktivitetit “Zjarri i Lirisë” në mbështetje të Hashim Thaçit, Kadri Veselit, Jakup Krasniqit dhe Rexhep Selimit.

Ish-ushtarë dhe bashkëluftëtarë të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, veteranë, familje të dëshmorëve dhe qytetarë, u bashkuan për të përcjellë një mesazh të përbashkët: lufta e UÇK-së ishte luftë për liri dhe historia e saj duhet të mbrohet me dinjitet.

Nga Zona Operative e Nerodimes u kërkuar drejtësi dhe liri për ish-krerët e UÇK-së që ndodhen në Hagë, ndërsa u ritheksua mbështetja për sakrificën, luftën dhe vlerat mbi të cilat është ndërtuar liria e Kosovës.

“Zjarri i Lirisë” po bashkon, nga njëra zonë operative në tjetrën, bashkëluftëtarë dhe qytetarë rreth kujtesës, solidaritetit dhe kërkesës për drejtësi.

Nga Nerodimja, mesazhi është i qartë: Liri për çlirimtarët, nderim për UÇK-në.

Dogana paralajmëron: 430 euro është kufiri pa taksa për mallrat personale në aeroport

PRISHTINË, 10 SHTATOR - Dogana e Kosovës ka njoftuar për kontrollet që kryhen në Aeroportin Ndërkombëtar të Prishtinës, duke rikujtuar udhëtarët për rregullat doganore gjatë hyrjes në Kosovë.

Sipas Doganës, zyrtarët doganorë kryejnë kontrolle të bagazheve dhe përdorin edhe skanerët si pajisje ndihmëse për identifikimin e mallrave që mund të jenë objekt i deklarimit.

Dogana ka bërë me dije se udhëtarët që kalojnë përmes kanalit të gjelbër, duke deklaruar se nuk kanë mallra për të deklaruar, mund t'i nënshtrohen kontrollit doganor.

Për udhëtarët që hyjnë në Kosovë përmes trafikut ajror, kufiri i patatueshëm për mallrat e destinuara për nevojat personale është 430 euro për udhëtar.

Në rastet kur vlera e mallrave personale tejkalon këtë kufi, udhëtarët duhet t'i deklarojnë ato në kanalën e kuq. Më pas, zyrtari doganor i informon për procedurat e mëtejshme doganore.

Dogana e Kosovës ka theksuar se mbetet e përkushtuar për mbrojtjen e interesave të qytetarëve dhe ekonomisë së vendit si dhe në parandalimin dhe luftimin e kontrabandës dhe veprimtarive të tjera të paligjshme.

Dogana u ka bërë thirrje udhëtarëve që të informohen dhe të deklarojnë saktë mallrat në mënyrë që udhëtimi të jetë në përputhje me legjislacionin doganor.



KEK-u ndal Njësinë A4 për arsye teknike

PRISHTINË, 10 SHTATOR - Korporata Energjetike e Kosovës ka bërë me dije se në mesnatë është bërë ndalja e kontrolluar e Njësisë A4 për shkak të rritjes së disa parametrave në sistemin ujë - avull të procesit teknologjik. KEK-u thekson se ndalja e njësisë është masë e domosdoshme parandaluese, e ndërmarrë me qëllim të mbrojtjes së pajisjeve, parandalimit të ndonjë defekti

me përmasa më të mëdha dhe ruajtjes së kushteve të sigurta të operimit. “Korporata Energjetike e Kosovës njofton se sonte, më 9 shtator 2026, në orën 24:00, do të realizojë ndaljen e kontrolluar të njësisë A4, për shkak të rritjes së disa parametrave në sistemin ujë - avull të procesit teknologjik. Ndalja e njësisë është masë e domosdoshme parandaluese, e ndërmarrë me qëllim të mbrojtjes së pajisjeve,

parandalimit të ndonjë defekti me përmasa më të mëdha dhe ruajtjes së kushteve të sigurta të operimit. Ekipet profesionale janë në gjendje gatishmërie dhe do të ndërmarrin menjëherë veprimet e nevojshme për vlerësimin e gjendjes teknike dhe trajtimin efikas të situatës, brenda një kohe optimale. Për rikthimin e njësisë A4 në operim, opinioni do të njoftohet me kohë”, ka njoftuar KEK-u.



ÇMIMET E KONSUMIT NË KOSOVË RRITEN 7.3 PËR QIND NË MUAJIN GUSHT

PRISHTINË, 10 SHTATOR - Agjencia e Statistikave e Kosovës (ASK) ka publikuar Indeksin e Harmonizuar të Çmimeve të Konsumit (IHÇK) për muajin gusht 2026. Indeksi i tërësishëm i harmonizuar i çmimeve të konsumit ishte më i lartë në një mesatare prej 7,3 % në muajin gusht 2026 krahasuar me muajin gusht 2025. Në muajin gusht 2026 Indeksi i Harmonizuar i Çmimeve të

Konsumit (IHÇK) është rritur 7,3 % krahasuar me muajin gusht 2025. Rritja është ndikuar nga grupet kryesore të COICOP-it: transporti (21,1 %), strehim, ujë, energji elektrike, gaz dhe lëndë të tjera djegëse (11,8 %), restorante dhe shërbime akomodimi (5,4 %), pije alkoolike, duhan dhe narkotikë (5,1 %), shëndetësi (4,2 %), kujdesi personal, mbrojtja sociale dhe mallra e shërbime të ndryshme (3,8 %), mobilje, pajisje



shtëpiake dhe mirëmbajtje rutinore shtëpiake (3,4 %), rekreacion, sport dhe kulturë (3,4 %), veshje dhe këpucë (3 %), ushqime dhe pije joalkoolike (2,6%) dhe informacion dhe

komunikim (0,6 %). Rënie e çmimeve është regjistruar në grupin: shërbimet arsimore (-0,5 %). Në muajin gusht 2026 Indeksi i Harmonizuar i Çmimeve të Konsumit (IHÇK) është rritur me 1,3 % krahasuar me muajin korrik 2026. Rritja është ndikuar nga grupet kryesore të COICOP-it: transporti (4,6 %), strehim, ujë, energji elektrike, gaz dhe lëndë të tjera djegëse (0,8 %), mobilie,

pajisje shtëpiake dhe mirëmbajtje rutinore shtëpiake (0,5 %), ushqime dhe pije joalkoolike (0,4 %), shëndetësi (0,4 %), informacion dhe komunikim (0,4 %), rekreacion, sport dhe kulturë (0,4 %), restorante dhe shërbime akomodimi (0,3 %), pije alkoolike, duhan dhe narkotikë (0,1 %), veshje dhe këpucë (0,1 %) dhe kujdesi personal, mbrojtja sociale dhe mallra e shërbime të ndryshme (0,1 %).

BQK-JA DHE SEKTORI BANKAR AVANCOJNË PËRGATITJET PËR FUNKSIONALIZIMIN E PAGESAVE TË SHPEJTA PËRMES PROJEKTIT TIPS CLONE

EPOKA E RE **Faton DËRMAKU**

PRISHTINË, 10 SHTATOR - Në vazhden e aktiviteteve për modernizimin e infrastrukturës së pagesave dhe avancimin e integritimit financiar me standardet evropiane, Banka Qendrore e Republikës së Kosovës (BQK) zhvilloi një takim me drejtuesit e bankave për të diskutuar përparimin e sistemit të pagesave të shpejta përmes projektit TIPS Clone për funksionalizimin e tij deri në fund të këtij viti si dhe zhvillimin e mëtejshëm të shërbimeve që do të mbështeten në këtë infrastrukturë moderne të pagesave. Ngjarja është vijimësi e takimeve të mëparshme rreth koordinimit të duhur ndërmjet BQK-së dhe sektorit bankar, me fokus në gatishmërinë institucionale, teknike dhe operative për vënien



në funksion të sistemit, modelin e pjesëmarrjes dhe funksionimit, si dhe hapat e nevojshëm për sigurimin e një zbatimi të suksesshëm. Në mesazhin e tij, guvernatori i BQK-së, Ahmet Ismaili, theksoi se projekti TIPS Clone përfaqëson një nga projektet më të rëndësishme për modernizimin e

sektorit financiar në Kosovë dhe një hap të rëndësishëm drejt përafrimit me standardet dhe infrastrukturën evropiane të pagesave. Ai vlerësoi se sistemi do ta mundësojë realizimin e pagesave të menjëhershme në kohë reale, 24 orë në ditë, shtatë ditë në javë dhe gjatë gjithë vitit, duke ofruar shërbime më të

shpejta, më efikase dhe me kosto më të ulët për qytetarët dhe bizneset. Nga BQK u vlerësua se TIPS Clone dhe SEPA janë projekte plotësuese dhe strategjike për zhvillimin e tregut financiar. Përderisa SEPA ofron kornizën për integrimin në tregun evropian të pagesave, TIPS Clone krijon infrastrukturën që mundëson pagesa të shpejta, rrit efikasitetin e shërbimeve të pagesave dhe krijon bazën për zhvillimin e zgjidhjeve të reja digjitale. U theksua se faza aktuale e projektit do të fokusohet në pagesat e shpejta brenda vendit, ndërsa në fazat pasuese synohet zgjerimi drejt pagesave rajonale ndërkufitare, në përputhje me zhvillimet e përbashkëta në Ballkanin Perëndimor, pjesë e projektit TIPS Clone. Në perspektivë, objektivi strategjik mbetet ndërlidhja e kësaj infrastrukture me ekosistemin

evropian të pagesave, duke mbështetur më tej integrimin financiar dhe pjesëmarrjen e Kosovës në SEPA. Për realizimin e këtij projekti strategjik, BQK-ja ka siguruar mbështetje financiare përmes grantit të Qeverisë së Republikës së Kosovës, të financuar nga Banka Botërore, në bazë të marrëveshjes ndërkombëtare të ratifikuar nga Kuvendi i Republikës së Kosovës. Kjo mbështetje do të kontribuojë në zhvillimin dhe funksionalizimin e infrastrukturës së pagesave të shpejta si dhe në avancimin e komponentëve të tjerë të projektit, në nivel të sektorit financiar të vendit. BQK-ja do ta vazhdojë koordinimin e ngushtë me sektorin bankar dhe partnerët ndërkombëtarë, duke përcjellë nga afër avancimin e përgatitjeve dhe duke mbështetur zbatimin e suksesshëm të projektit.

OEK-u fuqizon bashkëpunimin me komunat përmes rrjetit të Zyrave të Diasporës

PRISHTINË, 10 SHTATOR - Oda Ekonomike e Kosovës zhvilloi takim me përfaqësues të drejtorive komunale për zhvillim ekonomik, me fokus në forcimin e bashkëpunimit dhe lidhjen e potencialeve ekonomike të komunave me rrjetin e Zyrave të Diasporës të OEK-së. Në fokus të diskutimit ishin

nevojat dhe prioritetet e komunave, me synim krijimin e mundësive të reja për investime, bashkëpunim biznesor dhe promovim të potencialeve lokale në tregjet ndërkombëtare. Në takim morën pjesë edhe përfaqësues të Departamentit për Diplomaci Ekonomike të Ministrisë së Punëve të

Jashtme dhe Diasporës, duke kontribuar në koordinimin më të mirë ndërinstitutional. OEK-u do të vazhdojë të punojë me komunat dhe institucionet për të krijuar ura më të forta me diasporën dhe për ta kthyer potencialin e saj në mundësi konkrete për zhvillimin ekonomik të Kosovës.



'LUFTË' NË THELLËSI, NATO BLOKON ARMËN SEKRETE RUSE, DO TË SABOTONTE KABLOT NËNUJORE NË ARKTIK

Në ujërat e Arktikut, pranë arkipelagut të largët të Svalbardit, këtë pranverë, aleatët e NATO-s zbuluan disa nëndetëse ruse që po stërviteshin për të përdorur një armë sekrete, të projektuar për të dëmtuar kabllot kritike nënujore pa lënë gjurmë, raporton Agjencia e lajmeve Reuters.

Operacioni i fshehtë rus, i përshkruar për Reuters nga dy zyrtarë perëndimorë, u zhvillua nga GUGI, drejtoria ruse për luftën nënujore, e cila përdori mjete zhytëse në thellësi të mëdha për të simuluar përdorimin e një teknologjie të sofistikuar dhe shkatërruese.

Një operacion i përbashkët i Britanisë së Madhe, Norvegjisë dhe Shteteve të Bashkuara gjurmoi dhe u përball me anijet ruse në det, thanë dy zyrtarët, të cilët folën në kushte

anonimiteti. Anijet u penguan të përfundonin stërvitjen dhe më pas u larguan nga zona. Britania dhe Norvegjia njoftuan në prill se kishin zbuluar një operacion të fshehtë rus në ujërat e Arktikut. Por zbulimi i armës së re, vendndodhja e operacionit dhe përfshirja e Shteteve të Bashkuara nuk ishin bërë më parë publike.

Përballja në thellësi të detit vjen në një kohë kur disa zyrtarë perëndimorë të inteligjencës druhen se Kremlinu po intensifikon operacionet e sabotimit në Europë dhe po përgatitet për një konflikt të mundshëm me NATO-n.

Disa analistë të inteligjencës amerikane janë gjithnjë e më të shqetësuar se Rusia mund të vërë në provë parimin e mbrojtjes së përbashkët të NATO-s, të njohur si Neni 5,

thanë tre zyrtarë amerikanë. Nëse kjo ndodh, shkatërrimi i kabllave nënujore mund të jetë një pjesë e rëndësishme e kësaj strategjie, thanë zyrtarët perëndimorë.

Kabllot, disa prej të cilave nuk janë më të trasha se një zorrë uji për vaditje, shtrihen në fund të detit ose janë të groposura pak nën të. Ato janë jetike për lidhjen globale të internetit dhe transaksionet financiare. Rëndësia e tyre ekonomike dhe strategjike i ka bërë objektiva edhe në konfliktet e mëparshme, përfshirë Luftën e Parë dhe Luftën e Dytë Botërore, kur ishin thelbësore për transmetimin e urdhrave përmes telegrafit dhe telefonit. Dy kabllot nënujore me fibra optike, secili rreth 1400 kilometra i gjatë, lidhin Svalbardin me Norvegjinë kontinentale dhe shtrihen deri

në 2700 metra nën sipërfaqen e detit. Ato transmetojnë sasi të mëdha të të dhënave satelitore të shkarkuara në stacionin tokësor satelitor SvalSat, më i madhi në botë dhe pjesë e rrjetit të NASA-s për komunikimet pranë hapësirës. Ministria ruse e Mbrojtjes nuk iu përgjigj kërkesës për koment lidhur me incidentin. Kremlinu mohon në mënyrë të vazhdueshme se kryen operacione sabotimi në vendet e NATO-s ose se po planifikon ndonjë përballje me aleancën. Disa zyrtarë perëndimorë argumentojnë se aktivitetet ruse kundër vendeve evropiane janë shtuar muajt e fundit, ndërsa fronti në Ukrainë ka mbetur kryesisht i pandryshuar.

Polonia, Lituania dhe Rumania janë ndër vendet që kanë konfirmuar shkelje të

ndryshme. Së fundmi, një përpjekje për sulm me dron ndaj aeroportit Leipzig/Halle në Gjermani, në gusht, shkaktoi një sërë reagimesh nga Berlina, përfshirë mbylljen e një konsullate ruse në Bon dhe të një qendre kulturore ruse në Berlin.

Në gusht, drejtori i CIA-s, John Ratcliffe, vizitoi homologët e tij të inteligjencës në Moskë, pjesërisht për ta paralajmëruar Rusinë kundër përshkallëzimit të operacioneve të sabotimit në Evropë, thanë dy persona të njohur me këtë çështje.

Reuters nuk mundi të përcaktonte nëse Ratcliffe ngriti gjatë takimeve edhe çështjen e operacioneve të fshehta ruse nënujore. Kremlinu nuk pranoi të komentojë përmbajtjen e bisedimeve apo të jepte detaje të tjera.



GJERMANIA GATI PLANIN, SYNON TË FUSË INTELIGJENCËN ARTIFICIALE NË OPERACIONET USHTARAKE



Ushtria gjermane po shqyrton rreth 30 mjete të inteligjencës artificiale (AI) që synojnë të përshpejtojnë procesin e vendimmarrjes në fushëbetejë. Synimi është që një prej këtyre sistemeve të arrijë fazën e prototipit gjatë vitit 2027, ndërsa vendosja e plotë parashikohet për vitin pasardhës.

Viceadmirali Thomas Daum, drejtues i Komandës Kibernetike të ushtrisë gjermane, është shprehur optimist se një prototip mund të jetë gati në tremujorin e dytë të vitit 2027, me zbatimin e plotë të teknologjisë që pritet të nisë në 2028.

Lufta në Ukrainë ka nxjerrë në pah rolin gjithnjë e më të

rëndësishëm të dronëve dhe satelitëve, të cilët prodhojnë dhe mbledhin sasi të mëdha informacioni.

Përdorimi i inteligjencës artificiale shihet si një mënyrë për t'i përpunuar dhe analizuar këto të dhëna në një kohë shumë më të shkurtër se sa do të mund ta bënin operatorët njerëzorë, raporton Reuters.

AUDIENCA IMAGJINARE ÇLIROHU: ASKUSH NUK PO TË VËZHAGON AQ SA MENDON TI

Efekti që ka tek ne audienca imagjinare: Pse mendojmë se të gjithë po na shohin? Na duket sikur të tjerët vënë re çdo gabim, çdo pasiguri, çdo detaj të pamjes sonë. Psikologjia ka një lajm të mirë: pjesën më të madhe të kohës, njerëzit janë shumë më të zënë duke menduar për veten. Por rrjetet sociale po e komplikojnë këtë histori

Hyn në një dhomë plot me njerëz dhe papritur bëhesh i vetëdijsëm për mënyrën si ecën. Për rrobat që ke veshur. Për flokët. Për duart që nuk di ku t'i mbash. Për faktin që ndoshta the diçka të pavend pak më parë.

Bën një gabim gjatë një prezantimi dhe e mendon gjithë mbrëmjen. Publikon një fotografi dhe pas pak minutash kontrollon kush e ka parë. Thua diçka të sikletshme në një tavolinë dhe, tri ditë më vonë, ndërsa je duke bërë diçka krejt tjetër, truri ta rikthen papritur skenën: “Pse e thashë atë? Në mendjen tonë, diku në sfond, ekziston shpesh një publik që na sheh, na vlerëson dhe na gjykon.

Vetëm se në shumicën e rasteve ky publik është shumë më pak i interesuar për ne nga sa mendojmë.

Psikologjia e njeh prej dekadash këtë fenomen. Dhe historia e tij fillon me një ide të formuluar nga psikologu amerikan David Elkind në vitet 1960: “audienca imagjinare”.

Publiku që jeton në kokën tonë

Elkind po studionte një periudhë veçanërisht të çuditshme të jetës njerëzore: adoleshencën.

Në një moment të zhvillimit, fëmija fiton një aftësi të re dhe të jashtëzakonshme. Ai fillon të kuptojë më mirë se njerëzit e tjerë kanë mendimet, opinionet dhe këndvështrimet e tyre. Dhe këtu lind një paradoks. Tani që adoleshenti është në gjendje të mendojë për atë që mendojnë të tjerët, ai fillon të mendojë shumë për “atë që të tjerët mendojnë për të”.

Nëse unë jam i shqetësuar për puçrrën në fytyrën time, supozoj se edhe të tjerët po e shohin.

Nëse unë mendoj vazhdimisht për mënyrën si dukem, më duket sikur edhe ata po mendojnë për mënyrën si dukem.

Nëse unë ndihem në siklet, kam përshtypjen se sikleti im është i dukshëm për të gjithë. Kështu krijohet ajo që Elkind e quajti “audienca imagjinare”: ndjesia se jemi vazhdimisht përpara një publiku që na vëzhgon. Është një nga ironitë më interesante të psikologjisë njerëzore: bëhemi aq të aftë për të imagjinuar mendjen e njerëzve të tjerë, sa fillojmë ta mbushim atë mendje me... veten tonë.



Nuk mbaron me adoleshencën

Në teori, me kalimin e viteve duhet të kuptojmë se bota nuk sillet rreth nesh. Dhe në një masë të madhe, kështu ndodh.

Një studim me 850 adoleshentë, i botuar në “Journal of Personality”, e lidhi audiencën imagjinare me vetëdijen e shtuar për mënyrën se si dukemi para të tjerëve dhe sugjeroi se fenomeni zakonisht zbehet gjatë zhvillimit. Por historia nuk është aq e thjeshtë: studiuesit kanë debatuar për dekada mbi shpjegimin fillestar të Elkind dhe faktorët që e mbajnë gjallë këtë ndjesi edhe më vonë.

Sepse diçka nga ai adoleshent vazhdon të jetojë brenda të rriturit. Vetëm se psikologjia sociale i ka dhënë fenomenit edhe një emër tjetër shumë të bukur: spotlight effect – efekti i prozhektorit.

Imagjino sikur ecën nëpër jetë me një prozhektor mbi kokë. Ti e ndien dritën, prandaj supozon se edhe të tjerët po të shohin. Por prozhektori është shumë më i fortë në kokën tënde sesa në sytë e tyre.

Në një seri eksperimentesh të famshme, psikologët Thomas Gilovich, Victoria Medvec dhe Kenneth Savitsky treguan se njerëzit priren të mbivlerësojnë sesa shumë të tjerët vënë re pamjen dhe sjelljen e tyre. Ne jemi qendra e eksperiencës sonë dhe pikërisht për këtë arsye e kemi të vështirë të vlerësojmë saktë sa periferikë jemi në eksperiencën e dikujt tjetër.

Kjo shpjegon shumë gjëra. Njollën në këmishë që mendon se e panë të gjithë. Emrin që

harrove në mes të prezantimit. Fjalinë që të doli gabim. Momentin kur u pengove. Fotografinë ku mendon se dukesh tmerrësisht keq. Për ty, ngjarja është në qendër të skenës. Për dikë tjetër, mund të ketë qenë një detaj pesësekondësh në një ditë të mbushur me problemet e veta.

Edhe të tjerët kanë prozhektorin e tyre

Këtu shpjegohet pjesa më çliruese e gjithë kësaj historie. Arsyeja pse njerëzit nuk po mendojnë aq shumë për ty nuk është domosdoshmërisht se nuk u intereson. Është sepse po mendojnë për veten.

Ndërsa ti hyn në një festë dhe pyet veten nëse të tjerët po shohin se nuk njeh askënd, një tjetër po pyet veten nëse po duket i mërzitshëm.

Ndërsa ti shqetësohesh për pesë kilogramët që ke shtuar, dikush tjetër po mendon për flokët e vet. Ndërsa ti kujton fjalinë e gabuar që the dje, personi përballë mund të jetë duke ripërsëritur në kokë një fjali të gabuar që tha vetë. Secili prej nesh është protagonist i filmit të vet dhe personazh dytësor në filmat e të tjerëve. Problemi lind kur ngatërrojmë këto role. Mendojmë se jemi protagonistë edhe në mendjen e njerëzve të tjerë, por ja që zakonisht nuk jemi.

... dhe erdhën rrjetet sociale

Por Elkind formuloi teorinë e tij në vitin 1967. Nuk kishte

Instagram dhe as TikTok. Nuk kishte “seen”, “likes”, “views”, komente, followers dhe një numër të vogël që të tregonte, në kohë reale, sa njerëz kishin parë diçka nga jeta jote. Teknologjia ka bërë diçka paradoksale: i ka dhënë audiencës imagjinare një audiencë reale.

Kur publikon një fotografi, njerëzit vërtet e shohin. Kur shkruan një opinion, njerëzit vërtet mund ta gjykojnë. Kur bën një video, një numër real të tregon sa vetë e panë.

Madje, studimet mbi sjelljen online flasin tashmë për “audiencën imagjinare” – publikun që kemi në mendje ndërsa postojmë. Një studim që ndoqi 119 të rritur dhe rreth 1,200 postime në rrjete sociale zbuloi se njerëzit, edhe kur publikojnë potencialisht për një audiencë të madhe dhe heterogjene, shpesh imagjinojnë një publik shumë më konkret: miq, familjarë, kontakte profesionale ose një grup të caktuar njerëzish. Dhe ky publik mendor ndryshon nga një postim të tjetri. Rrjetet sociale e kanë bërë kufirin mes audiencës reale dhe asaj imagjinare gjithnjë e më të paqartë.

Kur fillojmë ta shohim veten me sytë e të tjerëve

Kostoja më e madhe nuk është domosdoshmërisht narcizmi. Mund të jetë diçka tjetër: Fillojmë ta përfetojmë veten nga jashtë. Nuk pyesim a më pëlqen kjo, por si do duket. Nuk pyesim a po e shijoj këtë

udhëtim, por çfarë fotografie do të postoj prej tij? Nuk pyesim çfarë mendoj, por si do të reagojnë nëse e them?

Një studim me 150 adoleshentë dhe të rinj të moshës 11–21 vjeç gjeti lidhje mes përdorimit më intensiv të rrjeteve sociale dhe mënyrës se si pjesëmarrësit mendonin se i vlerësonin bashkëmoshatarët, si edhe me një vetëkoncept më pak pozitiv në disa fusha. Studiuesit, megjithatë, nuk gjetën prova bindëse për pasojat klinike afatgjata dhe theksuan se marrëdhënia është komplekse.

Ky kujdes është i rëndësishëm. Rrjetet sociale nuk shpikën nevojën tonë për miratimin e të tjerëve. Ato thjesht i dhanë asaj njëso matëse.

Audienca imagjinare: Një mësim i vogël për jetën


Ndoshta për këtë arsye ideja e “audiencës imagjinare” është shumë më tepër se një term psikologjie zhvillimore. Ajo përmban një mësim të vogël për jetën. Sa gjëra nuk kemi bërë sepse kemi menduar: Çfarë do të thonë njerëzit? Sa herë nuk kemi folur sepse kishim frikë se mos dukeshim budallenj?

Sa rroba nuk kemi veshur? Sa ide nuk kemi provuar? Sa herë kemi kërkuar të dukemi perfektë përpara një publiku që, në të vërtetë, mezi po na kushtonte vëmendje?

Kjo nuk do të thotë se njerëzit nuk gjykojnë. Gjykimi ekziston. Thashethemet ekzistojnë. Tallja ekziston. Rrjetet sociale mund ta shumëfishojnë ekspozimin dhe ndonjëherë edhe mizorinë e tij. Por ne priremi të bëjmë një gabim tjetër: ngatërrojmë mundësinë që dikush të na gjykojë me idenë se të gjithë po na gjykojnë gjatë gjithë kohës. Janë dy gjëra krejt të ndryshme. Dhe dallimi mes tyre mund të jetë çlirues.

Herën tjetër kur të hysh në një dhomë dhe të mendosh se të gjithë po të shohin, kujto diçka: Edhe ata sapo kanë hyrë në dhomën e tyre mendore. Edhe ata kanë pasiguritë e tyre. Edhe ata mendojnë për mënyrën si duken, për atë që thanë, për atë që nuk duhej të kishin thënë, për përshtypjen që po lënë. Në një farë mënyre, secili prej nesh ecën nëpër botë nën një prozhektor imagjinar, duke menduar se është në skenë.

Ndërsa ti je i zënë duke menduar se çfarë mendon bota për ty, bota është kryesisht e zënë duke menduar se çfarë mendon ti për të. / [bota.al](#)



Xhudistët e Kosovës u kthehen garave të mëdha

BUDAPEST, 10 SHTATOR - Xhudistët e Kosovës këtë javë do t'u kthehen garave të mëdha. Ata do të paraqiten në Grand Slamin e xhudos në Budapest, i cili mbahet nga sot (e premte) deri të dielën.

Te xhudistët Akil Gjakova dhe Dardan Cena do të garojnë në kategorinë deri në 73 kilogramë. Ndërkohë, te xhudistët do të paraqiten Fatjona Kasapi në kategorinë deri në 52 kilogramë, Flaka Loxha në

57 kilogramë dhe Laura Fazliu në 63 kilogramë. Xhudistja Distria Krasniqi do të mungojë për shkak të një lëndimi. Në krye të ekipit do të jetë kryemjeshtri Driton Kuka. Në Budapest do të garojnë gjith-

sej 513 xhudistë nga 70 vende të ndryshme. Kosova synon medalje pavarësisht prej konkurrencës së fortë, pasi garat Grand Slam janë ndër më të rëndësishmet dhe më të fortat në sportin e xhudos.



MBI 1.7 MILION EURO DO TË INVESTOHEN NË PALESTRËN SPORTIVE NË ISTOG



ISTOG, 10 SHTATOR - Ministria e Rinisë dhe Sportit ka nënshkruar memorandum për renovimin e palestrës sportive në Istog në vlerë prej 1 milion e 734 mijë e 918 eurosh.

Njoftimin e ka bërë ministri në detyrë i Rinisë dhe Sportit, Blerim Gashani, i cili ka bërë me dije se memorandumit është nënshkruar së bashku me kryetarin e komunës së

Istogut, Ilir Ferati. Sipas Gashanit, ky investim synon përmirësimin e infrastrukturës sportive dhe krijimin e kushteve më të mira për sportistët dhe të rinjtë e Istogut. "Ditën e nisëm me një lajm të mirë për qytetarët e Istogut. Së bashku me kryetarin e Istogut, zotëri Ilir Ferati, sot nënshkruam memorandumin për renovimin e palestrës

sportive në Istog, me vlerë prej 1 734 918 eurosh", ka shkruar Gashani. Ai ka theksuar se investimi është konkret dhe në funksion të zhvillimit të sportit në këtë komunë. "Një investim konkret për përmirësimin e infrastrukturës sportive dhe krijimin e kushteve më të mira për sportistët dhe të rinjtë e Istogut. Vazhdojmë", ka shkruar Gashani.

GJILANI TRIUMFON NË DERBI NDAJ BALLKANIT, FERONIKELI '74 BEFASON DRITËN

PRISHTINË, 10 GUSHT - Gjilani ka shënuar fitore të rëndësishme në derbin e xhiros së pestë të Albi Mall Superligës së Kosovës, duke e mposhtur Ballkanin me rezultat 1:0. Ndeshja e zhvilluar në stadiumin me bar sintetik në Gjilan është vendosur nga Robert Rrahmani, i cili ka realizuar në minutën e 66 për t'ia siguruar skuadrës së Debatik Currit tri pikë të

vlefshme. Për Gjilanin kjo ishte fitorja e tretë në këtë edicion, pas një barazimi dhe një disfate në tri ndeshjet paraprake. Me këtë sukses, gjilanasit kanë arritur në kuotën e 10 pikëve dhe renditen në vendin e tretë. Në anën tjetër, Ballkani ka pësuar humbjen e dytë të sezonit, pas një serie prej tri fitoreve radhazi. Skuadra e drejtuar prej

Sami Sermexhajti mbetet me nëntë pikë dhe zbrit në pozitën e katërt.

Fitore të madhe ka regjistruar edhe Feronikeli '74, që në stadiumin "Rexhep Rexhepi" në Drenas e ka mposhtur kampionen në fuqi, Dritën, me rezultat 1:0.

Golin e fitores për skuadrën e Elon Berishës e ka shënuar Avni Selmani në minutën e 47. Për



Selmanin ky ishte goli i dytë në këtë edicion. Kjo ishte fitorja e

parë sezonale për Feronikelin 74. Pas pesë xhirove, skuadra nga Drenasi ka tri pikë dhe renditet në vendin e nëntë.

Drita, ndërkohë, ka pësuar humbjen e parë në kampionat nën drejtimin e trajnerit Ardian Nuhii. Kampionia në fuqi mbetet me shtatë pikë dhe renditet në vendin e gjashtë, me një ndeshje më pak të zhvilluar, atë ndaj Prishtinës.

TRAJNERËT E HUAJ "PUSHTOJNË" SUPERLIGËN E KOSOVËS NË BASKETBOLL

PRISHTINË, 10 SHTATOR - Sezoni 2026/27 në Superligën e Kosovës në basketboll do të nisë zyrtarisht fundjavën e ardhshme. Më 19 dhe 20 shtator do të zhvillohen ndeshjet e xhiros së parë, ku do të përballen Rahoveci 029 - Trepça, Bashkimi - Golden Eagle Ylli, Bora - Vëllaznimi dhe Sigal Prishtina - Peja. E veçanta e këtij

sezoni është se të tetë skuadrat e elitës së basketbollit të Kosovës do të drejtohen nga trajnerë të huaj.

Adis Beçiragiq do ta udhëheqë Trepçën për sezonin e katërt radhazi, pas dominimit total në tri sezonet e fundit me ekipin nga Mitrovica.

Bashkëpunimin me trajnerët e



huaj nga sezoni i kaluar e kanë vazhduar edhe Bashkimi, Bora,

Peja dhe Rahoveci 029.

Igor Jovović do të jetë në krye të Bashkimit, Zoran Kashqelan te Bora, Michalis Kakiouzis te Peja dhe Goran Samardžiev te Rahoveci 029.

Rami Hadar është rikthyer në basketbollin e Kosovës dhe në sezonin e ri do të jetë në krye të Golden Eagle Yllit, ndërsa

Jeronimo Sarin do ta drejtojë Sigal Prishtinën dhe Alek Jonçevski Vëllaznimin. Sezoni i ri në basketbollin e Kosovës do të nisë zyrtarisht me finalen e Superkupës së Kosovës ndërmjet Trepçës dhe Bashkimit. Kjo ndeshje do të zhvillohet më 15 shtator në palestrën "Mizahir Isma" në Rahovec.

Haaland planifikon largimin nga City në fund të sezonit

MANCHESTER, 10 SHTATOR - Sulmuesi Erling Haaland po planifikon të largohet nga Manchester City në fund të sezonit aktual, pasi thuhet se nuk është aspak i kënaqur me trajnerin Enzo Maresca. Në të vërtetë, Haaland po synon që verën e ardhshme të largohet

nga futbolli anglez për ta vazhduar karrierën në Spanjë. Është bërë më dije se agjentët e sulmuesit norvegjez tashmë kanë zhvilluar kontakte me përfaqësues të Barcelonës, klub që po synon transferimin e Haalandit. Te Barcelona kanë filluar ta shqyrtojnë

mundësinë e aktivizimit të klauzolës së lirimit të Haalandit, në vlerë prej 175 milionë eurosh, pasi ai ka kontratë me Cityn deri në vitin 2034.

Sulmuesi 26-vjeçar ishte bashkuar Cityt nga Borussia Dortmundi në vitin 2022,

ndërsa në sezonin aktual ka shënuar pesë gola në po aq paraqitje.

Krahas Barcelonës është raportuar se situatën e Haalandit te skuadra angleze po e monitorojnë edhe Real Madridi dhe Paris Saint-Germaini.





N.P.L. PALLATI I RINISË SH.A.
Prishtinë – Kosovë, Luan Haradinaj, p.n.
e-mail..contact@pallatirinise.com
www.pallatirinise.com



Në bazë të dispozitave të nenit 21, pikës 21.4 të Ligjit nr. 03/L- 087 Për Ndërmarrjet Publike, gjegjësisht nenit 13 të Ligjit nr. 04/L-111 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit nr.03/L-087 Për Ndërmarrjet Publike dhe në bazë të nenit 17 të Statutit, Bordi i Drejtorëve i N.P.L. PALLATI I RINISË SH.A., me datë 11.09.2026 bazuar mbi Vendimin Nr. 1/2058 publikon këtë:

KONKURS PUBLIK
Për plotësimin e një (1) pozite

- 1. Titulli i punës:** Këshilltar/e i/e Përgjithshëm – Sekretar/e Korporativ/e
Vendi: Prishtinë.
Ndërmarrja: N.P.L. PALLATI I RINISË SH.A. me seli në Prishtinë.
I përgjigjet: Bordit të Drejtorëve.
Mandati: 3 vite
Koeficienti: 5.9
- 2. Kushtet dhe kualifikimet e kërkuara:**
Bordi i Drejtorëve, dëshiron të sigurohet që të gjithë kandidatët potencial të jenë persona me integritet të lartë të cilët i plotësojnë kushtet e kualifikimit sipas nenit 17.1, (ii) i plotësojnë kriteret e pavarësisë sipas nenit 17.2, pikat (d), (f), (j), (k) dhe (l) (iii) nuk janë, ose në çfarëdo kohe gjatë periudhës tridhjetë e gjashtë (36) muajsh para datës së aplikimit nuk kanë qenë Drejtorë të Bordit të kompanisë gjegjëse dhe (iv) kanë përvojën e nevojshme profesionale dhe shkollimin e kërkuar për pozitën në fjalë; Çdo person i cili dëshiron të merret parasysh për një pozitë të drejtorit duhet që po ashtu t’i përmbushë edhe kushtet e përshtatshmërisë profesionale në vijim:

 - Të posedojë diplomë universitare -Fakulteti Juridik (jurist i diplomuar ose master në shkenca juridike);
 - Të posedojë së paku pesë (5) vite përvojë profesionale nga fusha e qeverisjes korporative ose të drejtës së shoqërive tregtare;
 - Të plotësojë kushtet e kualifikimit sipas nenit 17.1 si dhe të plotësojë kriteret e pavarësisë sipas nenit 17.2 pikat (d),(f),(j),(k),(l) të Ligjit nr. 03/L- 087 të Ndërmarrjeve Publike dhe Plotësim Ndryshimit të LNP nr. 04/L-111 neni 13;
 - Aftësi për punë ekipore;
 - Të ketë aftësi të mira komunikuese;
 - Të ketë etikë në punë dhe integritet.
 - Të posedojë njohuri të punës me kompjuter;
 - Njohja e gjuhës angleze (e dëshirueshme);
 - Dëshmitë mbi njohuritë dhe të arriturat tjera do të mirren në konsideratë dhe vlerësohen konform relevancës me vendin e punës;
 - Të jetë person me integritet të lartë dhe të plotësojë të gjitha kushtet e përshtatshmërisë të parapara me neni 17 të Ligjit të Ndërmarrjet publike nr. 03/L-087 , dhe plotësim ndryshimet përkatëse,Ligji për Parandalimin e konfliktit të interes në ushtrimin e funksionit public nr/06L-011, si dhe me normat tjera positive relevante.
- 3. Këshilltar/e i/e Përgjithshëm – Sekretar/e Korporativ/e ka këto detyra dhe përgjegjësi:**

 - Sigurohet që të përcillen procedurat e Bordit, ku bëjnë pjesë organizimi i takimeve të Bordit, Komiteteve të Bordit dhe Aksionarëve duke përfshirë (në bashkëpunim me Kryesuesin) përgatitjen dhe shpërndarjen e agjendave;
 - Mban regjistrin e aksionarëve;
 - Koordinon me KE përgatitjen e materialit për mbledhjet e Bordit të Drejtorëve;
 - Mban procesverbalin e mbledhjeve të Bordit të Drejtorëve dhe Komitetit të Auditimit (nëse nuk kërkohet ndryshe nga kryesuesit e tyre) dhe i regjistron në librat e protokolleve;
 - Shpërndan procesverbalet tek drejtorët dhe aksionarët;
 - Merret me regjistrimin zyrtar të ndryshimeve të cilat kërkohen sipas ligjit, i regjistron në regjistrin e Kosovës për shoqëritë tregtare dhe emrat tregtarë;
 - Sipas udhëzimeve nga Kryesuesi, përgjegjësitë e Sekretarit përfshijnë sigurimin e rrjedhjes së mirë të informatave brenda Bordit dhe komiteteve të tij dhe në mes të Bordit dhe menaxherëve të lartë të Ndërmarrjes;
 - Këshillat dhe shërbimet e Sekretarit duhet të jenë në dispozicion të të gjithë drejtorëve i cili njëheri është përgjegjës tek Bordi për të siguruar që përputhen procedurat e Bordit;
 - Përcjell ndryshimet ligjore që kanë të bëjnë me ndërmarrjen duke informuar Bordin dhe menaxhmentin e kompanisë për ndryshimet si dhe përgatitë udhëzimet e nevojshme për menaxhmentin e kompanisë.Merret edhe me çështjet tjera të qeverisjes korporative sipas nevojës.

- 4. Informatë për procedurën e konkurimit**

 - Kandidatët e interesuar për këtë vend pune duhet të bashkangjesin këto dokumente:
 - Formulari i kërkesës për punësim (aplikimit);
 - Kopje e letërnjoftimit; CV ; Çertifikata e lindjes;Letër motivimi;
 - Dëshmitë mbi Shkollimin dhe kualifikimin profesional e noterizuar;
 - Diplomat nga universitetet e huaja duhet të jenë të nostrifikuara nga Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë dhe e noterizuar.
 - Dëshmi për përvojën e punës/vërtetim i lëshuar nga institucioni përkatës i punësimit për përvojën e punës, që përcakton pozitën e punës si dhe kohëzgjatjen e angazhimeve në atë pozitë;
 - Pasqyrat e kontributeve pensionale (nuk kërkohet për përvoja të punës para themelimit të Fondit të Kursimeve Pensionale të Kosovës, dhe për ato përvoja kur punëdhënësit nuk kanë qenë të detyruar të paguajnë në këtë institucion);
 - Deklarata nën betim sipas neneve 17.1 dhe 17.2 të Ligjit të NP e cila mundë të shkarkohet nga uebfaqja e Kompanisë;
 - Certifikatë nga gjykata kompetente që nuk është duke u zhvilluar procedurë penale dhe që nuk është i dënuar për kryerjen e ndonjë vepre penale (jo më e vjetër se 6 (gjashtë) muaj nga data e lëshimit);
 - Lista e dokumenteve të dorëzuara.
- 5. Afati i Konkursit:**
Konkursi publik është i hapur në kohëzgjatje prej 30 (tridhjetë) ditë kalendarike nga data 11.09.2026 deri më 10.10.2026
Të interesuarit mund t’i dorëzojnë kërkesat (aplikacionet) e tyre me dokumentet tjera relevante në emailin: burimetnjerezore@pallatirinise.com
Formulari për kërkesë (aplikim) dhe Deklarata nën betim, mund të shkarkohen nga web-faqja e N.P.L. PALLATI I RINISË SH.A. me seli në Prishtinë në <http://www.pallatirinise.com/> ose mund të merren në zyrat e Ndërmarrjes.
- 6. Vërejtje:**
Kandidatët me dokumentacion të pakompletuar, të paplotësuar dhe jo-adekuat dhe jashtë afatit të konkurrimit, do të refuzohen.
Do të kontaktohen vetëm kandidatët të cilët i plotësojnë kriteret e përcaktuara dhe përfshihen në listën e ngushtë.

>> SHPALLJE TË VOGLA <<

- Milazim Dana shpall te pavlefshme 4 dëftesat dhe diplomën QK “11 Marsi” Prizren.

- Shaban Kryeziu shpall te pavlefshme diplomën QK “11 Marsi” Prizren.

- Driton Bucaj shpall te pavlefshme dëftesat e kl I - VIII shfmu “ Abdyl Frasheri “ Prizren.

- Armend Hoxhaj shpall te pavlefshme 3 dëftesat dhe diplomën Q K “11 Marsi “ Prizren.

- Trim Reznici shpall të pavlefshme dëftesën e kl.10 të sh.m.p “Gjon N. Kazazi” Gjakovë.

- Sokol Haxhikadrija shpall të pavlefshme diplomën e gjimnazit “Hajdar Dushi” Gjakovë.

- Elidon Pylla B.I. shpall të pavlefshme certifikatën e TVSH-së, me nr. 33049408.

- Elidon Pylla B.I. shpall të pavlefshme certifikatën e biznesit me nr. 811149542 të lëshuar nga ARBK.

- Genti Kurhasku shpall të pavlefshme certifikatën e maturës shtetërore të sh.m. mjekësisë “Hysni Zajmi” Gjakovë.

- Sebastjan Prenka shpall të pavlefshme dëftesën e plotë sh.f.f.m.u “Ahmet Rrustemi” Bec Gjakovë nga kl. 1-5 dhe 6-9.

- Xhelal Halilosmani shpall të pavlefshme dëftesat dhe diplomën e sh.m. Ekonomike “Kadri Kusari” Gjakovë.

- Diana Morina shpall të pavlefshme dëftesat e kl. 1.2.3.4 dhe diplomën e Gjimnazit “Hajdar Dushi” Gjakovë.

- Albana Gjocaj nga Juniku shpall të pavlefshme diplomën e universiteti Publik “Fehmi Agani” Gjakovë, drejtimi Infermieri, Bachelor me nr. 104.

- Atdhe Gashi shpall të pavlefshme dëftesat diplomën si dhe certifikatën e diplomës të shkollës së mesme Teknike “28 Nëntori” Prishtinë.


- Valmir Karavidaj shpall të pavlefshme dëftesën e shkollës fillore “Gjergj Kastrioti” në Mazdrek.

- Elton Halili shpall të pavlefshme dëftesën e klasës së 11 të shkollës së mesme të lartë të mjekësisë “Dr. Xheladin Deda”.

- Istref Hysni Nebiu shpall të pavlefshme Diplomën e Inxhinier i Diplomuar i Makineris në UB-me nr. 332.

- Shkendije Lushaj nga Gjakova shpall të pavlefshme diplomën e sh.m.l.m.”Hysni Zajmi” Gjakovë.

- Maurita Koca nga Bishtazhini KK Gjakovë shpall të pavlefshme dëftesën e kl.10 të Gjimnazit “Hajdar Duishi” Gjakovë.



N.P.L. PALLATI I RINISË SH.A.
Prishtinë – Kosovë, Luan Haradinaj, p.n.
e-mail..contact@pallatirinise.com
www.pallatirinise.com

Na osnovu odredbi člana 21, tačke 21.4 Zakona br. 03/L-087 o javnim preduzećima, odnosno člana 13 Zakona br. 04/L-111 o izmenama i dopunama Zakona br. 03/L-087 o javnim preduzećima i na osnovu člana 17 Statuta, Upravni odbor N.P.L. PALATI I RINISE AD, od 11.09.2026. godine, na osnovu Odluke Br. 1/2058 objavljuje ovo:

JAVNI KONKURS

Za popunjavanje jedne (1) pozicije

1. Naziv radnog mesta: Generalni savetnik - Sekretar preduzeća
Lokacija: Priština.

Preduzeće: N.P.L. PALATI I RINISE AD sa sedištem u Prištini.

Odgovoran: Upravnom odboru.

Mandat: 3 godine

Koeficient: 5.9

2. **Generalni svetnik - Sekretar preduzeća** ima sledeće dužnosti i odgovornosti: Upravni odbor želi da osigura da svi potencijalni kandidati budu osobe visokog integriteta koje ispunjavaju kvalifikacione uslove iz člana 17.1, (ii) ispunjavaju kriterijume nezavisnosti iz člana 17.2, tačke (d), (f), (j), (k) i (l) (iii) nisu, ili u bilo kom trenutku tokom trideset šest (36) meseci pre datuma podnošenja zahteva nisu bili, direktori Upravnog odbora relevantne kompanije i (iv) imaju neophodno stručno iskustvo i obrazovanje potrebno za predmetnu poziciju; Svako lice koje želi da bude razmatrano za poziciju direktora mora takode ispunjavati sledeće uslove stručne podobnosti:

- * Posjedovati univerzitetsku diplomu - Pravni fakultet (diplomirani pravnik ili master pravnih nauka);

- Posjedovati najmanje pet (5) godina stručnog iskustva u oblasti korporativnog upravljanja ili kompanijskog prava;

- * Ispunjavati kvalifikacione uslove iz člana 17.1 i ispunjavati kriterijume nezavisnosti iz člana 17.2, tačke (d), (f), (j), (k), (l) Zakona br. 03/L-087 o javnim preduzećima i izmene ZJP br. 04/L-111, član 13;

- Sposobnost za timski rad;
- Posjedovati dobre komunikacijske vještine;
- Posjedovati radnu etiku i integritet.
- Posjedovati računarske vještine;
- Znanje engleskog jezika (poželjno);
- Dokazi o drugim znanjima i dostignućima biće uzeti u obzir i procenjeni u skladu sa relevantnošću za posao;
- Biti osoba sa visokim integritetom i ispunjavati sve uslove podobnosti utvrđene članom 17 Zakona o javnim preduzećima br. 03/1.-087 i relevantnim izmenama, Zakonom o sprečavanju sukoba interesa u vršenju javnih funkcija br. 061.-011, kao i drugim relevantnim pozitivnim normama.

3. Generalni savetnik - Sekretar kompanije ima sledeće dužnosti i odgovornosti:

- Osigurati da se poštuju procedure Odbora, uključujući organizaciju sastanaka Odbora, odbora Odbora i akcionara, uključujući (u saradnji sa predsednikom) pripremu i distribuciju dnevnog reda;
- Voditi registar akcionara;
- Koordinirati sa Izvršnom komisijom pripremu materijala za sastanke Odbora direktora;
- Voditi zapisnike sa sastanaka Odbora direktora i Odbora za reviziju (osim ako njihovi predsednici ne zahtevaju drugačije) i evidentirati ih u zapisnicima;
- Koordinirati zapisnike direktorima i akcionarima;
- Obavljati zvaničnu registraciju promena koje zahteva zakon, evidentirajući ih u Kosovskom registru trgovačkih društava i trgovačkih imena;
- Prema uputstvima predsednika, odgovornosti Sekretara uključuju obezbeđivanje nesmetanog protoka informacija unutar Odbora i njegovih odbora i između Odbora i višeg menadžmenta Kompanije;
- Saveti i usluge Sekretara biće dostupni svim direktorima i biće odgovoran Odboru za obezbeđivanje usklađenosti sa procedurama Odbora;
- Prati pravne promene koje se odnose na Društvo tako što obaveštava Upravni odbor i rukovodstvo Društva o promenama i priprema neophodna uputstva za rukovodstvo Društva. Takode se bavi i drugim pitanjima korporativnog upravljanja po potrebi.

4. Informacije o postupku konkursa

- Kandidati zainteresovani za ovaj posao moraju priložiti sledeća dokumenta:
- Obrazac za prijavu za zaposlenje;
- Kopiju lične karte; CV; Izvod iz matične knjige rođenih;
- Motivaciono pismo;
- Overeni dokaz o obrazovanju i stručnoj kvalifikaciji;
- Diplome stranih univerziteta moraju biti overene od strane Ministarstva prosvete, nauke i tehnologije.
- Dokaz o radnom iskustvu/ potvrda izdata od strane nadležne institucije za zapošljavanje o radnom iskustvu, kojom se utvrđuje radno mesto i trajanje angažovanja na tom mestu;

4. Informacije o postupku konkursa

- Kandidati zainteresovani za ovaj posao moraju priložiti sledeća dokumenta:
- Obrazac za prijavu za zaposlenje;
- Kopiju lične karte; CV; Izvod iz matične knjige rođenih;
- Motivaciono pismo;
- Overeni dokaz o obrazovanju i stručnoj kvalifikaciji;
- Diplome stranih univerziteta moraju biti overene od strane Ministarstva prosvete, nauke i tehnologije.
- Dokaz o radnom iskustvu/ potvrda izdata od strane nadležne institucije za zapošljavanje o radnom iskustvu, kojom se utvrđuje radno mesto i trajanje angažovanja na tom mestu;
- Izjave o penzijskim doprinosima (nisu potrebne za radna iskustva pre osnivanja Kosovskog fonda za penzijsku štednju, i za ona iskustva kada poslodavci nisu bili u obavezi da plaćaju ovoj instituciji);
- Izjava pod zakletvom u skladu sa članovima 17.1 i 17.2 Zakona o JP koja se može preuzeti sa veb stranice Kompanije;
- Potvrda nadležnog suda da se ne vodi krivični postupak i da lice nije osuđivano za bilo koje krivično delo (ne starija od 6 (šest) meseci od datuma izdavanja);
- Spisak podnetih dokumenata.

5. Rok za konkurs:

Javni konkurs je otvoren u periodu od 30 (trideset) dana od 11.09.2026 do 10.10.2026.

Zainteresovana lica mogu podneti svoje prijave sa ostalom relevantnom dokumentacijom na imejl adresu: burimetnjerezore@pallatirinise.com

Obrazac za prijavu i izjava pod zakletvom mogu se preuzeti sa veb stranice N.P.L. PALATIRINISE AD sa sedištem u Prištini na <http://www.pallatirinese.com/> ili se mogu dobiti u kancelarijama Kompanije.

6. Napomena:

Kandidati sa nepotpunom, nekompletnom i neadekvatnom dokumentacijom i van roka za konkurs biće odbijeni.

Biće kontaktirani samo kandidati koji ispunjavaju navedene kriterijume i koji su uvršteni u uži izbor.



Gjej PUNË

- Lajme nga tregu i punes
- Shërbime shkrimi

Gjej Punë ofron shërbime drejtë përgaditjes së:

- CV-së
- Letrën Motivuese
- Parapregaditje për intervistë



www.facebook.com/gjejpunesshpejte

RESTAURANT

SWISS

TAVERNA

Tel: +377 45 400 156  +386 49 848 553

NJOFTIM

Njoftojmë të gjithë klientët se Shoqëria me Përgjegjësi të Kufizuar “Mishtore Steak” SH.P.K. me seli në Mitrovicë, ka marrë vendim të shuajë biznesin me nrb. 812434421 dhe ka caktuar likuidatorin për zhvillimin e procedurës së Likuidimit. Njoftohen të gjithë klientët që kanë raporte Kreditore - Debitorë në këtë korporatë që të paraqiten në afatin 30 ditor nga data e shpalljes në gazetë.

OBAVESTENJE

Obavestavanje se svi klienti da drustvo sa “Mishtore Steak” D.O.O. Mitrovica donelo odluku o prestani rada sa nrb. 812434421 ujedno imenovao Likvidatora o sprovođenju postupka likvidacije. Obavestavaju se svi klienti koji imaju obaveze i potraživanja u navedenoj firmi, da se jave u roku od 30 dana od dana objavljivanja o novine.

ANNOUNCEMENT

We inform al customers that the limited liability “Mishtore Steak” L.L.C. with headquarters Mitrovica, has come to the decision to quit its business: 812434421 the company has appointet a liquidator wsho is going to oversee the liquidator process. All clients who have the mortgager – mortgage accounts in this company are kindly request to show up within 30 days starting from the day of newspaper announcement- publication.

Duke u bazuar në Ligjin Nr. 08/L-181 për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis, Neni 16, pika 4, “Durimi” Sh.p.k., Vasilevë, Drenas, në bashkëpunim me Ministrin e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor dhe komunën organizojnë:

DEBAT PUBLIK

Për Raportin e Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis për Pëlqim Mjedisor, për shfrytëzimin, thërrmimin dhe seperimin i gurit gëlqeror në Strazhë, Komuna e Novobërdës.

Njoftohet publiku i interesuar se më datën 19.10.2026 në ora 09.00 në Shkollën fillore “Bora Stankovq” rruga Bora Stankovq nr.34, fshati Koretishtë, Komuna Novobërdës, do të organizohet debati publik nga “Durimi” Sh.p.k., Vasilevë, Drenas, në bashkëpunim me Ministrinë e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor dhe Komunën.

Debati Publik do të organizohet edhe në mënyrë virtuale në platformën online:

<https://us04web.zoom.us/j/5289487423?pwd=atEPUrNDxCwMcX5GSCHJS7NmAu7JDN.1>

Në linkun e mëposhtëm mund të gjeni raportin e VNM-së për “Durimi” Sh.p.k., Vasilevë, Drenas, për Pëlqim Mjedisor për Pëlqim Mjedisor për shfrytëzimin, thërrmimin dhe seperimin i gurit gëlqeror në Strazhë, Komuna e Novobërdës.

<https://mmphi.rks-gov.net/Document/Announcements?type=2>

Në emalin e mëposhtëm mund të dërgoni komentet lidhur me projektin lindita.morina@rks-gov.net

Pjesëmarrja e juaj na ndihmon ne implementimin e projektit.



MEKA
HALAL FOOD

TRADITË QË NGA 1992

